



QKRMT Qendra Kosovare për Rehabilitimin
e të Mbijetuarve të Torturës
KRCT The Kosova Rehabilitation
Center for Torture Victims

TË DREJTAT E NJERIUT NË INSTITUCIONET KORREKTUESE NË KOSOVË

RAPORT MONITORIMI 2021

Mbështetur nga
SIGRID RAUSING TRUST

**RAPORTI I
TREMBËDHJETË
VJETOR
MARS 2022**





QKRMT-KRCT

Qendra Kosovare për Rehabilitimin
e të Mbijetuarve të Torturës

The Kosova Rehabilitation
Center for Torture Victims

TË DREJTAT E NJERIUT NË INSTITUCIONET KORREKTUESE NË KOSOVË

RAPORTI MONITORUES – 2021

Monitorimi i të drejtave
të njeriut në institucionet
korrektuese mbështetet nga:

SIGRID RAUSING TRUST

Raporti i trembëdhjetë vjetor
Mars 2022, Prishtinë

Monitorimi i institucioneve korrektuese dhe sistemit gjyqësor në Kosovë është aktivitet që mbështetet nga Sigrid Rausing Trust [Mbretëri e Bashkuar] në kuadër të mbështetjes institucionale QKRMT-së.

Ky projekt menaxhohet dhe zbatohet nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës [QKRMT].

Vlerësimet dhe mendimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT, dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjen ose qëndrimet e SRT.

Vlerësimet, konkluzionet dhe rekomandimet në këtë raport janë rezultat i punës monitoruese dhe avokuese të ekipeve multidisiplinare të QKRMT përgjatë vitit 2021.

Autor: Fatmire Haliti

Kontribues: Albert Avdiu, Fisnik Mehmeti dhe Mehmet Musaj

Redaktor: Feride Rushiti

Monitoruesit:

Feride Rushiti

Fatmire Haliti

Albert Avdiu

Reshat Bajrami

Fisnik Mehmeti

Mehmet Musaj

Driat Cërabregu

Fatime Gërzhaliu

Nazmie Abdullahu Leku

Alban Muriqi [janar-prill 2021]

Contents

Shkurtesat.....	7
PARATHËNIE.....	8
MANDATI I QKRMT-së, METODOLOGJIA DHE QËLLIMI I MONITORIMIT	11
Mandati i sektorit për të drejtat e njeriut	11
Metodologjia	12
Qëllimi i monitorimit	13
I - PËRMBLEDHJA E GJETJEVE TË PËRGJITHSHME.....	17
1. MENAXHIMI I INSTITUCIONEVE KORREKTUESE	18
1.1. Mungesa e stafit në institucionet korrektuese	18
2. TRAJTIMI I TË BURGOSURVE.....	19
2.1. Keqtrajtimi dhe përdorimi i forcës.....	20
2.2. Dhuna dhe konfliktet mes të burgosurve	20
2.3. Vdekjet, vetëvrasjet, tentim-vetëvrasjet si dhe vetëlëndimet në burgje	21
2.4. Plani individual i trajtimit	23
2.5. Trajtimi i personave me çrregullime mendore	24
2.6. Vëzhgimi me kamera në dhomat e vetmisë	26
3. KONTRABANDA, KORRUPSIONI DHE APLIKIMI I STANDARDEVE TË DYFISHTA	27
4. NJËSIA EKONOMIKE NË SHKK.....	28
5. PROCEDURA E ANKESAVE	30
6. KUSHTET MATERIALE.....	30
7. USHQIMI DHE KUZHINA	33
8. ARSIMIMI, AKTIVITETET DHE ANGAZHIMI	33
9. SHËNDETËSIA NË BURGJE	35
10. MENAXHIMI I PANDEMISË COVID-19.....	37
11. PUNA E PANELIT PËR LIRIM ME KUSHT	38
12. TRAJTIMI I TË MITURVE GJATË PRIVIMIT NGA LIRIA	40
13. ADRESIMI I NDRYSHIMEVE LIGJORE	44
14. MARRËVESHJA PËR DHËNIEN ME QIRA TË QENDRËS SË PARABURGIMIT NË GJILAN	45

15. AVOKIMI DHE NDIHMA LIGJORE E QKRMT-SË	47
II - GJETJET NGA MONITORIMI I INSTITUCIONEVE KORREKTUESE	50
1. QENDRA KORREKTUESE NË DUBRAVË	51
2. BURGU I SIGURISË SË LARTË NË GËRDOC (BSL)	58
3. QENDRA KORREKTUESE NË SMREKONICË	63
4. QENDRA KORREKTUESE PËR FEMRA NË LIPJAN	68
5. QENDRA KORREKTUESE PËR TË MITUR NË LIPJAN	73
6. QENDRA EDUKATIVE KORREKTUESE NË LIPJAN	76
7. QENDRA E PARABURGIMIT NË PRISHTINË	81
8. QENDRA E PARABURGIMIT NË GJILAN	85
9. QENDRA E PARABURGIMIT NË PRIZREN	91
10. QENDRA E PARABURGIMIT NË PEJË	96

Shkurtesat

BSL – Burgu i Sigurisë së Lartë

DShB – Departamenti Shëndetësor i Burgjeve

GjEDNj – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

IPFK – Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës

LESP – Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale

MD – Ministria e Drejtësisë

MSh – Ministria e Shëndetësisë

PGjH – Pavion gjysmë i hapur

PLK – Paneli për Lirim me Kusht

QEK – Qendra Edukative Korrektuese

QK – Qendër Korrektuese

QKRMT – Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës

QKUK – Qendra Klinike Universitare e Kosovës

QP – Qendër Paraburgimi

ShKK – Shërbimi Korrektues i Kosovës

PARATHËNIE

Trajtimi njerëzor dhe respektimi i dinjitetit të personave të privuar nga liria janë rregull themelor dhe universalisht të zbatuara. Si të tilla, të drejtat e personave të privuar nga liria janë të mishëruar në dokumente ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare që kanë karakter ligjor të detyrueshëm.

Të paraburgosurit dhe të dënuarit janë veçanërisht në rrezik që t'u shkelen të drejtat, duke qenë se mbahen larg vëmendjes së opinionit. Prandaj, roli i shoqërisë civile si monitorues i jashtëm dhe i pavarur është thelbësor në parandalimin, dokumentimin dhe adresimin e shkeljeve të mundshme të të drejtave të njeriut në vendet e ndalimit në Kosovë.

Që nga themelimi i saj [1999], QKRMT ka punuar në parandalimin e torturës dhe rehabilitimin e të mbijetuarve të luftës në Kosovë. Mandati ynë mbetet unik, në kuptimin e realizimit të një misioni mjaft specifik, i cili fokusohet në luftimin e torturës përmes monitorimit dhe dokumentimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut, duke u ofruar ndihmë viktimave të torturës përmes programeve të saj rehabilituese.

Në këtë drejtim, realizimi i aktiviteteve monitoruese ka për qëllim vlerësimin e pajtueshmërisë dhe respektimit të standardeve ndërkombëtare në vendet e ndalimit; parandalimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut në këto vende, përsosmërinë e profesionalizmit dhe edukimin e institucioneve përgjegjëse, si dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve në frymën e humanizimit të sanksioneve penale.

Për më tepër, QKRMT përmes aktiviteteve avokuese ka ndikuar edhe në avancimin e ligjeve, politikave e strategjive për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në vendet e privimit nga liria, duke përfshirë edhe sistemin gjyqësor, gjegjësisht rastet që ndërlidhen me gjykimin e drejtë dhe zbatimin e paraburgimit. Prandaj edhe kemi ndërtuar një bashkëpunim profesional me sistemin Gjyqësor, me qëllim të promovimit të mbrojtjes gjyqësore të të

drejtave të personave të dënuar, duke përfshirë këtu edhe promovimin e rëndësisë dhe efikasitetin e lirimit me kusht.

Kësisoj, me qëllim të respektimit dhe promovimit të të drejtave për personat e privuar nga liria, gjatë vitit 2021 kemi realizuar 16 vizita monitoruese në institucionet korrektuese në Kosovë. Ky Raport, i cili ka dalë si rezultat i këtyre vizitave të rregullta monitoruese, në pjesën e parë të tij paraqet gjetjet në formë të përmbledhur, përderisa në pjesën e dytë këto gjetje janë të ilustruara ndaras, për secilin nga institucionet korrektuese të monitoruar, si dhe në fund janë paraqitur rekomandimet.

Gjetjet dhe rekomandimet e QKRMT-së, përveçse u shërbejnë institucioneve gjegjëse në avancimin e shërbimeve dhe trajtimit gjithherë më të mirë karshi personave të privuar nga liria dhe studiuesve profesional e shkencor, ato citohen në vazhdimësi nga raporte kredibile rajonale e ndërkombëtare [CPT, Raporti i Progresit i BE, Raporti i Departamentit të ShBA për të Drejtat e Njeriut etj.].

Për fund, QKRMT shpreh falënderimet për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe konstruktiv nga ana e ShKK-së dhe DShB-së. Gjithashtu, konsiderojmë si mjaft të rëndësishëm vlerësimin e punës sonë nga ana institucionale, pasi që shpeshherë autoritetet i janë përgjigjur pozitivisht rekomandimeve tona, duke ndërmarr hapa konkret për të përmirësuar kushtet dhe trajtimin e personave të privuar nga liria.

Dr. Feride Rushiti,
Drejtore Ekzekutive, QKRMT

MANDATI I QKRMT-së, METODOLOGJIA DHE QËLLIMI I MONITORIMIT

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) është organizatë e pavarur, joqeveritare dhe jo fitimprurëse, e themeluar në vitin 1999 me mision ofrimin e trajtimit dhe shërbimeve të rehabilitimit për viktimat e torturës dhe të keqtrajtuarve gjatë luftës në Kosovë.

QKRMT po ashtu është e angazhuar në promovimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut për të gjitha etnitetet në Kosovë si dhe në parandalimin dhe çrrënjosjen e torturës dhe çdo forme tjetër të keqtrajtimit, përmes monitorimit të të drejtave të njeriut në vendet e ndalimit në Kosovë.

Mandati i sektorit për të drejtat e njeriut

Sektori për të drejtat e njeriut udhëheq, koordinon dhe planifikon të gjitha aktivitetet e ndërlidhura me promovimin dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe ofrimin e ndihmës dhe këshillimeve ligjore për avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria, si dhe viktimave të torturës në përgjithësi. Në kuadër të këtij mandatit, QKRMT kryen monitorimin e rregullt në vendet e ndalimit, siç janë: burgjet, qendrat e paraburgimit, qendrat e mbajtjes në stacionet policore, institucionet e shëndetit mendor dhe të kujdesit social si dhe promovon praktika dhe standarde legjislative për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të personave të privuar nga liria.

Vizitat monitoruese në institucionet korrektuese realizohen në bazë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit me Ministrinë e Drejtësisë, e cila përcakton mënyrën e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe QKRMT-së, duke i mundësuar ekipeve monitoruese të QKRMT-së qasje të plotë në të gjitha institucionet korrektuese. QKRMT ka nënshkruar Marrëveshje Mirëkuptimi edhe me Departamentin Shëndetësor të Burgjeve – Ministria e Shëndetësisë për qasje në monitorimin e shëndetësisë në burgje.

Metodologjia

Monitorimi i të drejtave të njeriut në institucionet e mbyllura bazohet në indikatorët ndërkombëtarë të vlerësimit të të drejtave të njeriut në vendet e privimit të lirisë si: Normat e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës [KPT]; Rregullat Evropiane të Burgjeve [EPR], Rregullat Standarde Minimale për trajtimin e të burgosurve dhe Rregullat Nelson Mandela [SMR dhe NMR], etj., si dhe kornizën ligjore të aplikueshme në Kosovë, përfshirë Kodin Penal i Kosovës [KPK] dhe Kodi i Procedurës Penale i Kosovës [KPPK], Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale [LESP], Kodin e Drejtësisë për të Mitur, Ligjin për Shëndetin Mendor, etj., si aktet e tjera nënligjore. Ekipet monitoruese të QKRMT-së janë multidisiplinare (juristë, mjekë, punëtorë social dhe psikologë), ndërsa qasja në monitorim ka karakter parandalues dhe identifikues të çështjeve lidhur me trajtimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut në institucionet e ndalimit. Kështu, QKRMT ndërmerr vizita të rregullta; vizita tematike; dhe vizita të rastit [ad-hoc]. Ky raport përmbledhës identifikon çështjet kryesore dhe shpalos gjetjet nga 16 vizita monitoruese në institucionet korrektuese të Kosovës gjatë vitit 2021, që kanë të bëjnë me respektimin e të drejtave të njeriut në institucionet e ndalimit.

Kalendari i vizitave monitoruese të realizuara në institucionet korrektuese – 2021

Nr.	Data	Institucioni
1.	11.02.2021	Burgu i Sigurisë së Lartë në Gërdoc (BSL)
2.	24.02.2021	Qendra e Paraburgimit (QP) në Prishtinë
3.	21.05.2021	Qendra e Paraburgimit (QP) në Prizren
4.	11.06.2021	Qendra Korrektuese (QK) për të Mitur në Lipjan
5.	02.09.2021	Qendra Korrektuese (QK) në Dubravë
6.	06.10.2021	Qendra Korrektuese (QK) në Dubravë
7.	15.10.2021	Qendra Korrektuese (QK) për Femra në Lipjan
8.	28.10.2021	Qendra Korrektuese (QK) për Femra në Lipjan
9.	27.10.2021	Qendra e Paraburgimit (QP) në Pejë
10.	28.10.2021	Qendra Korrektuese (QK) në Smrekonicë
11.	18.11.2021	Qendra Edukuese Korrektuese (QEK) në Lipjan
12.	18.11.2021	Qendra Korrektuese (QK) për të Mitur në Lipjan
13.	23.11.2021	Burgu i Sigurisë së Lartë në Gërdoc (BSL)
14.	01.12.2021	Qendra e Paraburgimit (QP) në Gjiilan
15.	15.12.2021	Qendra e Paraburgimit (QP) në Prishtinë
16.	21.12.2021	Qendra Korrektuese (QK) në Dubravë

Qëllimi i monitorimit

E drejta për të mos iu nënshtruar torturës ose trajtimit mizor, çnjerëzor ose ndëshkimit është manifestuar në legjislacionin ndërkombëtar dhe kombëtar.


Monitorimi i vendeve ku mbahen personat e privuar nga liria është esencial, pasi ata janë të ndjeshëm dhe në rrezik për t'u keqtrajtuar dhe madje torturuar.

Personat e privuar nga liria kanë ndikim shumë të kufizuar në fatin e tyre dhe tërësisht varen nga autoritetet për të garantuar dhe mbrojtur të drejtat e tyre.


Monitorimi i institucioneve korrektuese dhe të paraburgimit kontribuon në më shumë transparencë dhe llogaridhënie dhe fuqizon legjitimitetin dhe besimin e opinionit në këto institucione.

Në mënyrë të veçantë, vizitat monitoruese të ndërmarra nga QKRMT-ja kanë për qëllim të sigurojnë:

- a) Vlerësimin e trajtimit dhe mbrojtjes së të dënuarve dhe të paraburgosurve;
- b) Vlerësimin e kushteve materiale dhe kushteve të jetesës në Qendrat Korrektuese si dhe të Paraburgimit;
- c) Një shqyrtim i parametrave tjerë relevant, duke përfshirë regjimin dhe aktivitetet, informimin, kontaktin me botën e jashtme, shëndetësinë, nevojat e veçanta të grupeve të rrezikuara/ndjeshme etj;
- d) Hartimin e gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve për udhëheqësit e institucioneve korrektuese, stafin e tyre, ShKK, DShB, MD, MSh dhe sistemin gjyqësor – gjykatat në Kosovë.



PËRMBLEDHJA E GJETJEVE TË PËRGJITHSHME



1. MENAXHIMI I INSTITUCIONEVE KORREKTUESE

Shërbimi Korrektues i Kosovës [ShKK], qendrat korrektuese dhe ato të paraburgimit, ka vite që nuk kanë menaxhment të qëndrueshëm me mandat të plotë. Po ashtu, me ndryshimet qeveritare në fillim të vitit 2021, Ministria e Drejtësisë kishte nisur procedurën për shkarkim ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të ShKK-së, i cili pas Vendimit të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Diciplinë u shkarkua nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm. Ministria e Drejtësisë gjatë muajve të parë të qeverisjes, bëri ndërrime dhe transferoi të gjithë drejtorët e institucioneve korrektuese, disa nga të cilët pas transferimeve u pezulluan / shkarkuan nga detyrat.

Drejtorët e institucioneve korrektuese janë ndërruar, pezulluar apo shkarkuar nga detyra kryesisht për shkak të procedurave disiplinore apo hetimore, por edhe për arsye të transferimit apo zëvendësimit. Rrjedhimisht, kjo mungesë e menaxhmentit funksional dhe me kompetenca e përgjegjësi të plotë, ka ndikim drejtpërsëdrejti në menaxhimin e institucioneve korrektuese, duke përfshirë edhe trajtimin e të burgosurve.

Ministria e Drejtësisë, gjatë muajit nëntor 2021 ka publikuar procedurat për përzgjedhjen e drejtorit të përgjithshëm të ShKK-së, mirëpo konkursi është anuluar për shkaqe ligjore. Kurse, sa i përket drejtorëve të rinj të institucioneve korrektuese në Kosovë, deri në fund të vitit 2021, Ministria e Drejtësisë nuk ka iniciuar ndonjë procedurë për plotësimin e vendeve të lira.

1.1. Mungesa e stafit në institucionet korrektuese

Mungesa e stafit, si e zyrtarëve korrektues po ashtu edhe e stafit profesional, siç janë punëtorët social paraqet sfidë në menaxhimin e institucioneve korrektuese për ShKK. Përveç numrit të vogël të stafit, në këtë drejtim shqetësuese është edhe moshja mesatare e stafit e cila, në disa institucione korrektuese është mbi 50 vjeç. Kjo paraqet një sfidë shtesë në performancën e përgjithshme të institucioneve korrektuese.

2. TRAJTIMI I TË BURGOSURVE

Qëllimi kryesor i vizitave monitoruese është vlerësimi i respektimit të të drejtave të njeriut në vendet e privimit nga liria. Gjatë realizimit të vizitave, QKRMT ka monitoruar aspektet e trajtimit të dënuarve dhe të paraburgosurve, duke përfshirë kategorizimin dhe regjimet e të dënuarve, shërbimet e ofruara dhe trajtimin mjekësor, rastet eventuale të keqtrajtimit fizik dhe psikik, konfliktet mes të dënuarve dhe të paraburgosurve si dhe aspekte të tjera që ndërlidhen me trajtimin e të burgosurve.

QKRMT vlerëson se kategorizimi dhe regjimet kanë pasur progres të përgjithshëm, sidomos në institucionet ku objektet e banimit janë të ndërtuara rishtazi, duke mundësuar sistemim adekuat të të dënuarve dhe të paraburgosurve. Ndërsa, në institucionet korrektuese ku objektet janë të vjetra, kategorizimi është sfidues për shkak të mungesës së hapësirave adekuate. Kështu, në QK në Dubravë regjimet janë të ndara dhe parashihet vendosja e të dënuarve sipas kategorive. Mirëpo, vendosja e tyre është e përzier, pasi që brenda të njëjtit pavijon vendosen të dënuar të kategorive të ndryshme, që përfshijnë vepra të ndryshme penale, lartësinë e dënimit, moshën, gjendjen shëndetësore, varshmërinë, sjelljet, etj.

Shqetësuese mbetet vendosja dhe trajtimi i personave të moshuar, personave me probleme shëndetësore kronike, me çrregullime mendore si dhe përdoruesit e substancave narkotike. Përzierja e këtyre kategorive me të dënuarit e tjerë, është vështirë e menaxhueshme për shkak të specifikave që kanë.

Në përgjithësi të dënuarit dhe të paraburgosurit raportojnë për sjellje të mira dhe njerëzore nga stafi korrektues. Megjithatë, ka raste të caktuara kur raportohet se zyrtarët korrektues i ofendojnë dhe ngacmojnë me fjalë. Po ashtu, në disa raste monitoruesit kanë pranuar pohime për keqtrajtim fizik nga stafi korrektues ndaj të burgosurve.

2.1. Keqtrajtimi dhe përdorimi i forcës

Keqtrajtimi dhe përdorimi i forcës ndaj të dënuarve dhe të paraburgosurve nuk është dukuri që është evidentuar në të gjitha institucionet korrektuese, megjithatë QKRMT ka pranuar pohime për keqtrajtim dhe përdorim të forcës ndaj të dënuarve, të paraburgosurve dhe të miturve. QKRMT ka pranuar pohime për përdorim të forcës ndaj të burgosurve në këto institucione: Qendra Korrektuese në Dubravë, Burgu i Sigurisë së Lartë, Qendra e Paraburgimit në Prishtinë dhe Qendra Korrektuese për të Mitur në Lipjan.

QKRMT me profesionalizëm ka trajtuar këto ankesa dhe ka vërejtur se përdorimi i forcës ndaj tyre ka qenë evident. Përveç bisedave të drejtpërdrejta me të burgosurit të cilët kanë raportuar rastet e keqtrajtimit, QKRMT ka kërkuar informacione nga menaxhmenti i institucionit rreth këtyre rasteve, ka shikuar dosjet mjekësore dhe protokollet shëndetësore. Megjithëse jo çdo herë kanë qenë evidencat e rregullta për këto raste, është vërejtur që forca është përdorur.

Rastet e keqtrajtimit janë adresuar tek menaxhmenti i institucioneve, i cili e ka vlerësuar si të domosdoshëm dhe proporcional përdorimin e forcës me qëllim të vënies së situatës nën kontroll. Mirëpo, gjatë çdo vizite monitoruese ekipi monitorues paraprakisht takohet me menaxhmentin e institucionit dhe nuk kishte pranuar informacion për përdorim të forcës proporcionale për këto raste, përkundër që ishin pyetur nga monitoruesit e QKRMT-së. Për më tepër, institucionet korrektuese nuk kanë paraqitur protokolle apo procedura përkatëse për trajtimin e këtyre rasteve. Dy nga rastet e raportuara, QKRMT i ka adresuar te Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë.

2.2. Dhuna dhe konfliktet mes të burgosurve

Dukuria e dhunës dhe konflikteve në mes të burgosurve mbetet prezentë në institucionet korrektuese. Rastet të dhunës dhe konflikteve në mes të burgosurve janë evidentuar thuajse në të gjitha institucionet korrektuese,

por kjo dukuri më e theksuar është në QK Dubravë, BSL, QK për të Mitur dhe QK për Femra. Rastet e tilla shpesh herë kanë përfunduar me lëndime në mes të burgosurve.

2.3. Vdekjet, vetëvrasjet, tentim-vetëvrasjet si dhe vetëlëndimet në burgje

Gjatë vitit 2021 janë evidentuar 9 vdekje në institucionet korrektuese, nga të cilat 3 kanë qenë vetëvrasje. Të burgosurit që kanë ndërruar jetë gjatë qëndrimit në burg, kryesisht kanë qenë raste me sëmundje kronike.

Tri vetëvrasjet në burgje janë kryer nga personat me çrregullime mendore. QKRMT ka monitoruar këto raste, nga të cilat një vetëvrasje ka ndodhur në QP në Prishtinë, një në QP në Prizren, si dhe rasti i fundit në QK për Femra në Lipjan. *QKRMT vlerëson se të tri rastet e vetëvrasjes kanë ndodhur në institucionet korrektuese ku nuk është dashur që të vendosen personat e tillë për shkak të gjendjes së rënduar të shëndetit mendor.*

E dënuara 22 vjeçare e cila u vetëvra në dhomën e saj në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan kishte probleme të rënda të shëndetit mendor. QKRMT e kishte vizituar të dënuarën disa muaj para vetëvrasjes, ku ajo po mbahej e vetme në një dhomë dhe nuk ishte në gjendje të kujdesej për vetën dhe veprimet e saj.

I paraburgosuri që ka kryer vetëvrasjen në QP Prizren, ishte me çrregullime të shëndetit mendor, për të cilin avokati i tij kishte bërë kërkesë që të zëvendësohet masa e paraburgimit me masa të tjera dhe t'i bëhet ekzaminimi mjekësor, mirëpo kjo kërkesë nuk ishte marrë parasysh nga gjykata kompetente.

Vetëvrasja që ndodhi në QP në Prishtinë, ishte kryer nga i paraburgosuri 33 vjeçar, i cili kishte urdhëresë nga gjykata për masën e paraburgimit, e cila ishte caktuar që të zbatohet në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (IPFK), për shkak të gjendjes së rënduar të shëndetit të tij mendor. Në mungesë të vendeve të lira në IPFK, i paraburgosuri ishte vendosur në QP

Prishtinë, në kundërshtim me vendimin e gjykatës si dhe me dispozitat ligjore në fuqi. Pra, i paraburgosuri në kohën kur realizoi vetëvrasjen po mbahej në një institucion ku me vendim të gjykatës nuk duhej të mbahej. *Në këtë rast, institucionet të cilat nuk e kanë zbatuar vendimin e gjykatës për vendosjen dhe trajtimin e tij në Institutin e Psikiatrisë Forenzike duhej të merrnin përgjegjësinë për dështimin për mbrojtjen e jetës së tij.*

Një praktikë e tillë, përveç që është në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale, gjithashtu është në kundërshtim edhe me standardet ndërkombëtare për trajtimin e të burgosurve me çrregullime mendore. GjEDNJ në shumë raste ka konstatuar se vendosja e personave me probleme shëndetësore në institucionet korrektuese, në të cilat nuk ka kushte adekuate për trajtimin e tyre, paraqet shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut [Neni 3 – Ndalimi i Torturës].¹

Përveç vetëvrasjeve të kryera gjatë vitit 2021, ka pasur disa raste që kanë mbetur në tentativë. Këto raste janë parandaluar falë reagimit të menjëhershëm të stafit korrektues dhe stafit shëndetësor në parandalimin e tyre.

ShKK dhe Departamenti Shëndetësor i Burgjeve (DShB) kanë themeluar dhe funksionalizuar komisionet e veçanta për zbatimin e strategjisë për parandalimin e vetëvrasjeve në burgje.

Gjatë periudhës raportuese DShB ka vlerësuar se 136 të burgosur janë me rrezik të lartë për të bërë vetëvrasje, të cilët janë trajtuar në mënyrë të veçantë nga komisionet e themeluara për këtë qëllim. Gjatë vitit 2021, 25 të burgosur kanë tentuar të bëjnë vetëvrasje, ndërsa 3 prej tyre kanë arritur të kryejnë vetëvrasje.²

¹ Dybeku v. Albania 18.12.07; Rupa v. Romania 16.12.08; Arrêt de chambre G. c. France 23.02.2012;

² Raporti vjetor i punës së DShB për vitin 2021

Një ndër shqetësimet e adresuara nga stafi korrektues dhe stafi shëndetësor është menaxhimi i rasteve të vetëlëndimit. Krahasuar me vitet paraprake, gjatë vitit 2021 ka pasur rënie të numrit të vetëlëndimeve [në vitin 2020 janë evidentuar 130 ndërsa në 2021 janë evidentuar 102 raste të vetëlëndimeve].³

Vetëlëndimet kryesisht realizohen për shkak të pakënaqësive të ndryshme që kanë të burgosurit, siç janë pakënaqësitë ndaj gjykatave (dënimet apo paraburgimet), për shkak të ankesave ndaj stafit korrektues, refuzimit të kërkesave për transfere në institucionet më afër familjes përderisa disa të burgosurve iu aprovohen kërkesat, ankesa për mosrealizimin e beneficioneve, etj.. Po ashtu, ka raste që vetëlëndimet janë shkaktuar për arsye shëndetësore, kur kanë kërkuar shërbime shëndetësore brenda ose jashtë institucionit dhe nëse nuk është realizuar kërkesa e tyre, kanë shkaktuar vetëlëndime. Raste të tilla kanë ndodhur kur stafi shëndetësor ka aplikuar standarde të dyfishta ndaj të burgosurve, ku disa të burgosur të privilegjuar janë dërguar në vazhdimësi për vizita mjekësore jashtë institucioneve korrektuese, ndërsa të tjerët kanë pritur kohë të gjatë për realizimin e vizitave të tilla. Arsye të tjera që kanë rezultuar në vetëlëndime janë çështjet familjare apo edhe pakënaqësitë e tjera.

Gjatë adresimit të dukurisë së vetëlëndimeve, përgjigjet e stafit korrektues dhe stafit shëndetësor shpeshherë kanë qenë se të burgosurit vetëlëndohen kryesisht për ta tërhequr vëmendjen apo për të arritur ndonjë qëllim [realizim të ndonjë kërkesë]. *QKRMT në vazhdimësi ka rekomanduar që indikacionet për vetëlëndime duhet të trajtohet me profesionalizëm dhe pa paragjykim.*

2.4. Plani individual i trajtimit

Ndikim të rëndësishëm në trajtimin e të burgosurve paraqet zhvillimi i planeve individuale, që ende mungojnë në institucionet korrektuese. Përmes këtyre planeve do të duhej të hartoheshin programe specifike për secilin të burgosur dhe kështu do të rezultonte dukshëm në përgatitjen e të burgosurve për risocializim dhe gjithashtu në rehabilitimin e tyre. Në këtë

³ Raporti vjetor i punës së DShB për vitin 2021

mënyrë, do të arrihej edhe synimi për t'i përgatitur për jetë normale pas vuajtjes së dënimit si dhe do të zvogëlohej mundësia e përsëritjes së veprave penale. Së fundmi, QK në Dubravë ka filluar aplikimin e planit individual mirëpo ende është në fazën fillestare.

Sa i përket rasteve të reja që pranohen, përkatësisht të dënuarit që paraqiten vullnetarisht për vuajtje të dënimit, ata vlerësohen në Njësinë për Vlerësim dhe Klasifikim të Burgosurve e cila gjendet në QP Prishtinë. Gjatë qëndrimit 28 ditor në këtë njësi, të dënuarit klasifikohen se në cilën qendër korrektuese do të vuajnë dënimin.

2.5. Trajtimi i personave me çrregullime mendore

Menaxhimi adekuat i personave me çrregullime mendore mbetet ndër sfidat kryesore në trajtimin e të burgosurve në Kosovë. Brenda institucioneve korrektuese nuk ka asnjë institucion të veçantë për vendosjen dhe trajtimin e kryerësve me çrregullime mendore.

Përveç vështirësive për trajtimin dhe menaxhimin e rasteve me çrregullime mendore, sfiduese mbetet parandalimi i vetëvrasjeve të personave me çrregullime mendore, ku tri rastet e vetëvrasjeve të ndodhura në burgje gjatë vitit 2021, janë kryer nga personat me çrregullime mendore.

Pas rastit të vetëvrasjes që ka ndodhur në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, në Gusht 2021, QKRMT ka bërë thirrje publike për Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës, për ndërmarrjen e masave të menjëhershme për krijimin e hapësirave dhe kushteve të nevojshme për vendosjen dhe trajtimin e kryerësve me çrregullime mendore.

Në raportimet e vazhdueshme të QKRMT-së, është potencuar pamundësia për trajtimin e këtyre rasteve brenda institucioneve korrektuese, duke evidentuar:

- mungesën e ofrimit të shërbimeve psikiatrike të vazhdueshme;
- mungesën e hapësirave adekuate;

- mungesën e kapaciteteve të stafit korrektues, si dhe
- rrezikun e mundshëm të shkaktuar nga kryerësit me çrregullime mendore, duke përfshirë edhe vetëlëndimet dhe vetëvrasjet.

Ministria e Drejtësisë ka nisur procedurën për përshtatjen e Pavijonit D në QK Dubravë për vendosjen dhe trajtimin e kryerësve me çrregullime mendore. Realizimi i këtij projekti planifikohet të ndodhë gjatë vitit 2022. Në fund të vitit 2021 ShKK ka hapur konkursin për pranimin e 30 zyrtarëve korrektues dhe 2 punëtorëve social për Pavijonin D. Aty pritet të angazhohen edhe 11 infermierë, 1 mjek, 1 psikiatër dhe 1 psikolog, të cilët do të jenë të pranishëm në këtë Pavijon në baza të rregullta.

QKRMT e ka mirëpritur këtë nismë të Ministrisë së Drejtësisë. Mirëpo pas monitorimit të këtij procesi, QKRMT mbetet e shqetësuar se planifikimet për adaptimin e këtij institucioni vetëm do ta zbusin situatën në trajtimin e personave me çrregullime mendore. Kjo formë e menaxhimit nuk ofron zgjidhje adekuate dhe të qëndrueshme për situatën në të cilën gjendet Shërbimi Korrektues në menaxhimin e këtyre rasteve. Ky pavijon planifikohet të trajtojë të burgosurit me nevoja të veçanta (me probleme mendore, me sëmundje tjera, me varësi nga narkotikët, etj).

Pavijoni D fillimisht ishte ndërtuar për vendosjen e dëshmitarëve të mbrojtur dhe dëshmitarëve bashkëpunues, mirëpo ka disa vite që nuk është funksional. Kapaciteti i këtij institucione në kohën kur ka qenë funksional ishte për 20 persona, ndërsa me ri-funksionalizimin e tij dhe adaptimin për vendosjen e personave me nevoja të veçanta, pritet që aty të vendosen 60 persona.

Pritjet që do të bëhet zgjidhje për vendosjen dhe trajtimin e të burgosurve me çrregullime mendore nuk janë të realizueshme për shkak se numri i të burgosurve me çrregullime mendore në institucionet korrektuese është shumë më i lartë se sa kapaciteti i planifikuar në këtë Pavijon. Vetëm në QP Prishtinë gjatë vizitës së fundit monitoruese të QKRMT-së ishin rreth 40 raste me çrregullime mendore.

Për më tepër, sipas planifikimeve aktuale, në Pavijonin D nuk është paraparë ndonjë hapësirë për të miturit dhe femrat e burgosura që kanë nevoja të veçanta shëndetësore. Edhe këto dy kategori të ndjeshme do të duhej të konsideroheshin nga institucionet relevante, në mënyrë që t'ju sigurohet trajtim i duhur dhe dinjitoz.

Me gjithë faktin se e vlerëson pozitivisht një nismë të tillë, QKRMT i inkurajon institucionet relevante që kjo problematikë të adresohet sipas nevojave dhe kërkesave për trajtimin e të burgosurve me nevoja të veçanta sipas specifikave që kanë, pasi që përzierja e të burgosurve të kategorive të ndryshme në këtë institucion do të jetë vështirë e menaxhueshme.

Me qëllim që të ofrohet një trajtim adekuat dhe menaxhim i mirëfilltë i të burgosurve me problemeve mendore, QKRMT rekomandon që të shtohen hapësira të reja edhe në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës, pasi që kapacitetet aktuale janë të pa përballueshme për kërkesat për ekzaminim dhe trajtim të detyrueshëm psikiatrik.

2.6. Vëzhgimi me kamera në dhomat e vetmisë

Në disa prej institucioneve korrektuese, janë ndërmarr veprime për rregullimin e dhomave të vetmisë, duke vendosur edhe kamera për vëzhgim për rastet që kanë nevojë për mbikëqyrje të vazhdueshme. Përkundër faktit se për raste të rënda të shëndetit mendor për institucionet korrektuese mbase mbetet alternativa e vetme me qëllim parandalimin e lëndimeve apo të vetëvrasjeve, megjithatë QKRMT rekomandon që kjo çështje të rregullohet me dispozita të veçanta përmes akteve nënligjore, në mënyrë që të shmangen mundësit e keqpërdorimit dhe shkeljes së privatësisë dhe dinjitetit të të burgosurve.

3. KONTRABANDA, KORRUPSIONI DHE APLIKIMI I STANDARDEVE TË DYFISHTA

Gjatë vizitave monitoruese të realizuara në vitin 2021, janë raportuar raste të vazhdueshme të kontrabandës brenda institucioneve korrektuese. Rastet më të shpeshta të kontrabandës kanë ndodhur në QK Dubravë. Burgu i Sigurisë së Lartë (BSL) mbetet shembulli më i mirë i parandalimit të kontrabandës.

QKRMT e vlerëson faktin se në krahasim me vitet e kaluara, ShKK gjatë vitit 2021 ka qenë mjaftë transparente duke i publikuar rastet e kontrabandës. Rastet e raportuar në publik nga ShKK janë ato raste që kanë arritur të parandalohen në hyrje të institucioneve korrektuese, kryesisht rastet përmes vizitave familjare apo edhe përmes stafit.

Shqetësuese mbeten rastet e kontrabandës ku të përfshirë janë stafi i institucioneve korrektuese. Gjatë monitorimit, QKRMT ka pranuar pohime nga të burgosurit se vet stafi janë të përfshirë në futjen e mjeteve të ndaluara brenda institucioneve korrektuese. Rastet më të shpeshta të kontrabandës janë me telefona celular, substanca narkotike, alkool etj.

Gjatë bisedave me të burgosurit, ata deklarojnë se kontrabanda në të shumtën e rasteve bëhet duke korruptuar stafin e institucioneve korrektuese. Gjithashtu, të burgosurit deklarojnë se edhe realizimi i beneficioneve dhe privilegjeve si dhe transferimet në institucionet e tjera korrektuese bëhen përmes korrupsionit. QKRMT ka pranuar pohime edhe për trajtim sipas standardeve të dyfishta për shumë të burgosur. Sipas tyre, këto beneficione iu mundësohen vetëm të dënuarve që kanë lidhje të drejtpërdrejta me zyrtarët e institucioneve korrektuese ose përmes korrupsionit. Janë raportuar rastet me dënime të gjata të cilët janë transferuar nëpër qendra të paraburgimit, përkundër që nuk i plotësojnë kushtet ligjore për transfere të tilla.

Këto pohime, dëshmhohen edhe me arrestimin e një zyrtari korrektues, i cili dyshohet se gjatë muajit gusht 2021, kishte pranuar 2,000.00 euro nga një i burgosur për ta transferuar nga pavijonet e tipit të mbyllur në Pavijonin Gjysmë të Hapur në QK Dubravë. Në nëntor 2021, Prokuroria Themelore në Pejë ngriti aktakuzë ndaj këtij oficeri korrektues.

Gjithashtu, është prezent edhe kontrabandimi brenda institucioneve, me theks të veçantë në QK Dubravë. Stafi i institucioneve korrektuese, raportojnë se të burgosurit që janë të angazhuar në punë, kryesisht në kuzhinë dhe në thertore, përvetësojnë produkte nga mishi si dhe gjëra të tjera ushqimore dhe higjienike, dhe të njëjtat i kontrabandojnë me të burgosurit e tjerë në kundër vlerë me cigare apo produkte të tjera.

4. NJËSIA EKONOMIKE NË ShKK

QKRMT dëshiron të sjell në vëmendjen e Ministrisë së Drejtësisë dhe ShKK-së nevojën për reforma dhe avancim të Njesisë Ekonomike. Funkcionalizimi i Njesisë Ekonomike duhet të trajtohet me prioritet duke mundësuar menaxhimin e të burgosurve të punësuar. Themelimi i Njesisë Ekonomike është paraparë me LESP të vitit 2013, mirëpo deri më tani nuk është themeluar si njësi e veçantë.

Një ndër aspektet më të rëndësishme që ndikon në rehabilitimin dhe risocializimin e të burgosurve është mundësia për tu angazhuar në punë gjatë vuajtjes së dënimit. Ofrimi i trajnimeve profesionale dhe angazhimi i të dënuarve në punë, përveç që ka efekte pozitive në trajtimin e të dënuarve, gjithashtu ka ndikim edhe në jetën jashtë institucioneve. Një i dënuar i cili ndjek trajnime profesionale dhe angazhohet në punë, do ta ketë shumë më të lehtë risocializimin pas vuajtjes së dënimit.

BSL është një nga institucionet me praktikën më të mirë për punësimin e të dënuarve. Gjatë vizitës së realizuar në nëntor 2021, 89 të dënuar ishin të angazhuar në punë (nga gjithsej 136 të dënuar prezent). Të dënuarit në BSL

kanë mundësi të punojnë në punëtoritë për prodhimin e letrës së tualetit, qeseve, produkteve të drurit, renovimet e ambienteve të institucionit, pastrim, kuzhinë, etj. BSL i furnizon qendrat tjera korrektuese me letër tualeti, e në raste të caktuara edhe me punime nga druri, siç janë tavolinat. Po ashtu në QK Dubravë të burgosurit angazhohen në punë të ndryshme, duke përfshirë edhe blegtorinë dhe prodhime bujqësore. Në QK Smrekonicë, të burgosurit janë të angazhuar në prodhime bujqësore, ku me disa nga produktet e kultivuara në këtë qendër [perime të ndryshme] furnizohen kuzhinat e thuajse të gjitha institucioneve korrektuese.

Në Qendrën Korrektuese për Femra, të dënuarat janë të angazhuara në rrobaqepësi, ku sikurse në vitin 2020 edhe gjatë vitit 2021 kanë vazhduar me qepjen e maskave për mbrojtje nga Covid-19. Të miturit në QEK kanë punuar me dizajne të ndryshme, duke shtypur gota dhe uniforma me shenja të ndryshme. Po ashtu, të miturit kanë arritur që suksesshëm të prodhojnë kokërr shilte të ndryshme për treg jashtë institucioneve korrektuese.

Në institucionet e tjera, të burgosurit kryesisht angazhohen vetëm në pastrim, kuzhinë, lavanderi dhe punë të tjera në mirëmbajtjen e institucioneve korrektuese.

Pagesa e të burgosurve të angazhuar në punë është 1.00 euro në ditë për të gjitha llojet e punëve që kryhen, pavarësisht a janë punë të thjeshta (p.sh. pastrim) apo edhe punë profesionale. Gjithashtu, në periudha të caktuara kohore, ka pasur ankesa nga të burgosurit për vonesa në ekzekutimin e pagesave.

Nga praktika e deritashme, mund të shihet se në mesin e të dënuarve të angazhuar në punë, ka edhe punë profesionale që kryhen nga të dënuarit. Këto punë përveç që sjellin përfitime, mundësojnë edhe kursime për buxhetin e ShKK-së. Në këtë drejtim kërkohet ndërmarrja e veprimeve adekuate, për përmirësimin e kushteve të punës për të dënuarit, përfshirë ngritjen e pagesës. Prandaj, është më se e nevojshme të funksionalizohet Njësia Ekonomike brenda ShKK-së.

5. PROCEDURA E ANKESAVE

Të burgosurit kanë deklaruar se mekanizmi i ankesave të brendshme nuk është i përshtatshëm dhe efikas. Sipas tyre, përgjigjet në ankesa janë të vonshme dhe shpesh e humbin efektin deri sa të marrin një përgjigje. Ata deklarojnë se ka raste kur nuk marrin asnjëherë përgjigje lidhur me ankesat e tyre, kështu që disa të burgosur nuk e aplikojnë procedurën e ankesave për arsye të vonesave në trajtim si dhe për arsye se mekanizmi aktual nuk siguron konfidencialitetin e të burgosurve. Është raportuar se ka raste kur stafi hakmerret ndaj të burgosurve që paraqesin ankesa ndaj tyre. QKRMT ka evidentuar disa raste kur mungonin fletat për paraqitjen e ankesave.

6. KUSHTET MATERIALE

Nga monitorimi i realizuar gjatë 2021, QKRMT vlerëson se akomodimi i të burgosurve në kuptimin e kushteve materiale në përgjithësi ka qenë në nivel të pranueshëm. Standardi i kushteve materiale për vendosjen e të burgosurve ndryshon varësisht nga institucioni. Gjatë viteve të fundit janë ndërtuar dhe funksionalizuar disa qendra të reja, të cilat kanë një nivel të kënaqshëm të kushteve materiale në përgjithësi. Gjithashtu gjatë vitit 2020 dhe 2021, janë kryer disa renovime në institucionet korrektuese, të cilat kanë ndikuar në përmirësimin e kushteve të përgjithshme të vendosjes së të burgosurve.

Megjithë këtë edhe në qendrat e ndërtuara viteve të fundit, janë evidentuar dëmtime të ndryshme infrastrukturore:

- QP Gjilan përballet me mungesën e ujit të ngrohtë; DysHEMEJA në korridore dhe muret e disa dhomave kanë qenë shumë të dëmtuara dhe nevojitet renovim. Për shkak të rrjedhjes së ujit, 10 dhoma ishin jashtë funksionit. Janë dëmtuar bateritë/çezmat dhe deri në sanimin e tyre këto dhoma nuk do të mund të përdoren;
- Në BSL, kati i parë i Pavijonit 2 është në gjendje më të dobët sa i përket kushteve materiale. DysHEMEJA është shumë e dëmtuar. Të dënuarit e katit të parë, kanë qenë në pritje të transferimit në katin e tretë të

- Pavionit 2, i cili ka përfunduar renovimet. Kati i dytë i Pavijonit 2 ka qenë jashtë funksionit, për shkak se kanë qenë duke u kryer punime;
- QP në Prishtinë që nga funksionalizimi i saj është përballur me sfida të ndryshme sa i përket kushteve materiale. Ka mungesë të ujit të ngrohtë. Disa pjesë të QP në Prishtinë i janë nënshtruar renovimit, e disa të tjera pritët të fillojnë ndërkohë. Në të ardhmen e afërt pritët të realizohet ndërtimi i një salle sporti si dhe një salle fitnesit.

Kushte materiale nën standardet e nevojshme janë evidentuar në QK Dubravë, QK Smrekonicë, QP Pejë, QP Prizren dhe QK për Femra në Lipjan.

Pavijoni 2 i QK Dubravë ka qenë jashtë funksionit, për shkak të rrjedhjes së ujit dhe planifikohet të rinovohet gjatë 2022. Pavijoni 3 dhe 5 kanë kushte më të dobëta materiale. Dyshemeja është shumë e dëmtuar nëpër korridore dhe në dhomat e të dënuarve. Pavijoni 5 ka kohë që nuk është renovuar. Edhe në këto dy Pavijone ka probleme me instalimet e rrymës dhe me ujë; në disa pjesë të pavijoneve pikonte uji. Në PGJH gjendja materiale e banjave ka qenë mjaftë e dobët, sidomos ajo në katin e dytë ku kishte vazhdimisht rrjedhje të ujit. Gjithashtu, instalimet elektrike të improvizuara nëpër dhomat e të burgosurve paraqesin rrezik për jetën e të burgosurve.

Në QP Pejë ka mungesë të ndriçimit natyror si dhe ventilimi nuk funksionon. Në muret e disa dhomave janë vërejtur gjurmë të lagështisë të formuara nga rrjedhjet e ujit, ndërsa në të gjitha banjot e dhomave të vizituara është vërejtur lagështi dhe formim i mykut. Gjithashtu në depon e ushqimit është vërejtur formim i mykut nga lagështia.

Edhe në QP Prizren ventilimi nuk është funksional, sidomos në dhomat brenda të cilave janë të vendosura tualetet, funksionimi i rregullt i ventilimit është i nevojshëm. Duke konsideruar se objekti është ndërtim i vjetër dhe hapësirat e ngushta për vendosjen e të burgosurve, ShKK duhet të konsiderojë rregullimin e ventilimit, më qëllim të ofrimit të kushteve më të mira për të burgosurit.

QK Smrekonicë ka një kohë që nuk ka pas ndonjë renovim brenda ambienteve të banimit. Muret nëpër disa nga dhomat e vizituara, sidomos në Krahun A, kanë qenë të dëmtuara dhe me myk. Banjat e përbashkëta janë të dëmtuara dhe kanë nevojë për renovime, sidomos intervenim më i shpejt nevojitet tek tavanit i banjave, pasi që panelet e tavanit janë demoluar tërësisht pas bastisjeve që ishin kryer dhe si rezultat kabllot e rrymës elektrike janë zbuluar dhe paraqesin rrezik potencial për të burgosurit.

Gjatë periudhës raportuese, Shërbimi Korrektues ka furnizuar me dyshekë anti-zjarr, batanije dhe jastëk të rinj shumicën e institucioneve korrektuese. QKRMT çdo vit ka raportuar për nevojën e këtij furnizimi, pasi që për më shumë se 10 vite nuk ka pasur furnizim të tillë. *Andaj QKRMT e vlerëson pozitivisht veprimin e ShKK-së për t'i pajisur me dyshekë dhe batanije institucionet korrektuese.*

Përveç në BSL ku të gjitha dhomat janë me nga një shtrat, në QP Prishtinë dhe QP Gjilan dhomat janë me nga një dhe dy shtretër, ndërsa në institucionet tjera korrektuese dhomat standarde janë me nga katër shtretër. Në QP Pejë, QP Prizren dhe QK për Femra, dhomat janë mjaftë të vogla për vendosjen e katër shtretërve.

Në QP Prishtinë, të burgosurit kanë shprehur ankesa për strukturën e shtretërve, të cilët janë njëri mbi tjetrin dhe nuk kanë shkallë për të hipur në shtratin e sipërm. Disa nga të burgosurit, vullnetarisht flinin në dysheme vetëm për të mos hipur në shtratin e sipërm për shkak se kishin vështirësi për të hipur pa shkallë, e disa kishin frikë nga lartësia.

Institucionet korrektuese vazhdojnë të përballën me mungesën e inventarit elementar për vendosjen e gjësendeve personale. Në mungesë të inventarit, të burgosurit janë të detyruar që rrobat dhe gjësendet personale t'i vendosin nën krevate, duke i futur nëpër qese apo pako nga kartoni. Monitoruesit kanë pranuar ankesa edhe sa i përket furnizimit me produkte higjienike.

7. USHQIMI DHE KUZHINA

QKRM i kushton rëndësi të veçantë edhe ushqimit që u shërbehet të burgosurve. Gjatë këtij viti janë vizituar kuzhinat e institucioneve korrektuese si dhe depot në të cilat ruhen rezervat e ushqimit. QKRMT vlerëson se niveli i ushqimit që shërbehet nëpër institucionet korrektuese, në përgjithësi është në një standard të pranueshëm.

Gjatë monitorimit është vërejtur se mostrat e ushqimit janë të ruajtura në mënyrë të duhur nëpër të gjitha institucionet korrektues. Gjithashtu, për punëtorët e kuzhinës, librezat sanitare kanë qenë të rregullta.

Në disa raste, monitoruesit e QKRMT kanë gjetur produkte ushqimore me afat të skaduar që mbaheshin në kuzhinat e institucioneve korrektuese. Këto gjetje janë adresuar tek institucionet relevante dhe është kërkuar ndërmarrja e veprimeve për t'i larguar nga përdorimi.

Edhe pse gjendja me ushqimin ka qenë përgjithësisht e mirë, në disa raste të burgosurit kanë paraqitur ankesa për cilësinë dhe sasinë e ushqimit. Në disa institucione, të burgosurit janë ankuar se përgatitja e ushqimit nuk është e mirë. Të burgosurit kanë paraqitur kërkesa që të lejohen më shumë artikuj ushqimor në kantinë, si dhe t'ju mundësohet lejimi i pakove ushqimore nga familjet.

8. ARSIMIMI, AKTIVITETET DHE ANGAZHIMI

Bazuar në Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, të burgosurve gjatë kohës së vuajtjes së dënimit ju takojnë një mori aktivitete me qëllim të risocializimit dhe rehabilitimit. Në këtë drejtim, të dënuarit kanë të drejtë të marrin pjesë në aktivitete shkollore, trajnime të aftësimit profesional, aktivitete sportive, etj.

Sa i përket shkollës, në QK në Dubravë dhe në QK për të Mitur në Lipjan ofrohet mundësia e ndjekjes së mësimi në shkollën brenda institucioneve. Disa të

miturve të dënuar iu është mundësuar edhe pjesëmarrja në studime në fakultet. Përveç aktiviteteve shkollore, të dënuarve, edhe pse jo mjaftueshëm, u ofrohen mundësi për ndjekjen e trajnimeve profesionale [Teknologji informative dhe kontabilitet; axhustator [saldues]; instalim të ujit dhe kanalizimit; ndërtimtari në qeramikë, murator, fasadë dhe latues; zdrukthëtari, rrobaqepësi, floktari, etj]. Gjatë vizitave monitoruese, nevoja për shtimin e trajnimeve profesionale është paraqitur nga një pjesë e madhe e të dënuarve të intervistuar.

Gjatë qëndrimit në institucionet korrektuese, të burgosurit kanë të drejtë në vizita të rregullta familjare. Të dënuarit, gjithashtu i shfrytëzojnë vizitat e veçanta familjare, po ashtu kanë të drejtë për telefonata. Varësisht nga niveli i regjimit dhe plotësimi i kritere tjera ligjore, të dënuarit kanë të drejtë në vikende, dhe gjatë vitit kanë të drejtë të dalin deri 7 ditë jashtë institucionit korrektues. Mbetet kërkesë e vazhdueshme e të dënuarve shtimi i ditëve jashtë institucioneve korrektuese.

Sa i përket aktiviteteve tjera, të burgosurit kanë të drejtë në shëtitje të rregullta ditore, në aktivitete fizike, të angazhohen në punë, qasje në bibliotekat e institucioneve korrektuese.

Një ndër të drejtat e të burgosurve është edhe e drejta në informim. Çdo i burgosur ka të drejtë të ketë qasje në shtypin ditor dhe atë periodik në gjuhën e tij amtare dhe në burime të tjera të informimit publik. Tashmë në Kosovë nuk kemi gazeta të shtypura të cilat do të mund tu shpërndareshin të burgosurve. Të burgosurve ju mundësohet posedimi i TV-së, mirëpo që programet e qasshme janë shumë të kufizuara. Në disa institucione të burgosurit kanë qasje në vetëm 3 kanale.

Me qëllim të respektimit të së drejtës për informim, dhe duke u bazuar edhe në trendet ndërkombëtare, QKRMT sugjeron që të afirmohet qasja në internet për të dënuarit, nën kushtet dhe specifikat e regjimit të dënimit. Një praktikë e tillë do të kishte efekte pozitive si në sjelljen e të dënuarve, po ashtu edhe në rehabilitimin dhe përgatitjen e tyre për periudhën e post-lirimit. Kësisoj, sugjerojmë që në mesin e mjeteve të informimit, të shtohet edhe opsioni i

qasjes së informacionit përmes internetit. Me zhvillimet e fundit teknologjike, mund të kufizohet qasja në shfletues dhe faqe të ndryshme të internetit, me çka institucionet korrektuese do të mund të kenë më të lehtë menaxhimin e qasjes në internet për të dënuarit.

9. SHËNDETËSIA NË BURGJE

Shëndetësia në burgje është e pavarur nga institucionet korrektuese dhe menaxhohet nga Departamenti Shëndetësor i Burgjeve (DShB), në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë. Qasja monitoruese e QKRMT-së ndaj shëndetësisë në burgje është mundësuar sipas Marrëveshjes së Mirëkuptimit me DShB.

Në kuadër të mandatit monitorues, QKRMT i kushton vëmendje të veçantë ofrimit të shërbimeve shëndetësore ndaj të burgosurve, ndërsa në fokus të veçantë ka pasur trajtimin e kategorive të ndjeshme, si personave me çrregullime mendore, rasteve të vetëlënduar, të lënduar dhe atyre të keqtrajtuar, përdoruesve të drogave, ata me sëmundje të rënda, me sëmundje ngjithëse, etj.

Gjatë vitit 2021, njësitë shëndetësore brenda institucioneve korrektuese kanë qenë mirë të pajisura dhe të furnizuara me produktet e nevojshme. Ka pasur furnizime me aparaturë moderne të cilat kanë lehtësuar punën e stafit shëndetësor.

QKRMT ka vlerësuar se ambientet dhe infrastruktura në disa institucione ka qenë e papërshtatshme, duke paraqitur vështirësi në ofrimin e shërbimeve adekuate ndaj të burgosurve. Institucionet me infrastrukturë të dobët mbesin QP Pejë, QP Prizren dhe QK për Femra në Lipjan. Përveç kushteve të dobëta në infrastrukturë, në këto institucione [QP Pejë dhe QK për Femra] njësitë shëndetësore gjenden në hapësirat e banimit ku kanë qasje të vazhdueshme të burgosurit.

Gjatë vitit 2021 janë mundësuar shërbimet stomatologjike në të gjitha institucionet korrektuese, megjithëse jo të gjitha kanë qenë funksionale [QP në Pejë ishte furnizuar me karrigen stomatologjike mirëpo deri në fund të vitit 2021 nuk ishte angazhuar stomatologu].

Sa i përket furnizimeve me barna, gjatë këtij viti nuk janë raportuar raste të mungesës së barnave elementare, me përjashtim të disa llojeve specifike të cilat është dashtë që vet të burgosurit t'i sigurojnë përmes familjarëve të tyre.

Gjatë vizitave monitoruese, në disa raste janë gjetur barna me afat të skaduar të vendosura bashkë me barnat në përdorim.

Shqetësim tjetër mbetet menaxhimi i barnave me afat të skaduar, ku në secilin institucion, barnat pa afat duhet që të zhvendosen nga barnatorja e institucionit në një hapësirë të veçantë, mirëpo ka disa vite që nuk është bërë asgjësimi i tyre dhe të njëjtat kanë mbetur të izoluara për disa vite.

Sa i përket trajtimit të të burgosurve, monitoruesit e QKRMT-së kanë pranuar ankesa në trajtimin shëndetësor, lidhur me humbjen e terminëve, mos trajtimin e kërkesave për kontrolle specialistike, ankesa të shumta në shërbimet stomatologjike në QK Dubravë etj. Sipas të burgosurve, kërkesat për trajtim shëndetësor nuk trajtohen çdo herë seriozisht dhe nuk i evidentojnë në listën e kontrolleve. Si pasojë, të burgosurit shpesh vetëlëndohen me qëllim që t'ju mundësohen kontrollet mjekësore.

Kërkesat më të mëdha nga të burgosurit janë për trajtim shëndetësor jashtë institucioneve korrektuese. Arsyet e vizitave jashtë institucionit janë se: nuk i besojnë shërbimeve brenda institucionit; konsiderojnë që nuk kanë trajtim të barabartë me të tjerët sepse raportojnë për disa të burgosur të privilegjuar që sipas tyre për shkak të standardit të dyfishtë dërgohen për vizita jashtë institucioneve korrektuese edhe pa pasur nevojë, përkatësisht ankesat e tyre shëndetësore nuk janë më të veçanta se të tjerat, etj.

Evidencat dhe protokollet mjekësore kanë rëndësi të veçantë në trajtimin e të burgosurve. Vetëm në disa prej qendrave, këto protokolle mbahen mirë dhe

sipas procedurave standarde. Në shumë qendra, evidencat shpesh janë të pasakta dhe në kundërtënie me dosjet mjekësore dhe evidencat e institucioneve korrektuese.

QKRMT i kushton kujdes të veçantë rasteve të dyshuara për keqtrajtim dhe evidentimit të tyre nga ana e stafit shëndetësor. Në disa raste kishte shpërputhje mes evidencave dhe protokolleve, lidhur me rastet e lëndimeve.

Në një rast në QEK, në dosjen personale të një të mituri ishte evidentuar lëndimi trupor, por evidentimi mungonte në protokollin e lëndimeve. Ky i mitur ishte lënduar në ditën kur figuronte në protokollin e izolimit si i mitur në karantinë, ndërsa lëndimin e kishte marrë në shkollë. Pra, kishte shpërputhje mes 2 protokolleve dhe dosjes personale. Po ashtu, në QK Dubravë një rast që kishte gëlltitur 20 tableta ishte evidentuar në protokollin e tentim-vetëvrasjeve, ndërsa rasti tjetër që kishte gëlltitur 81 tableta ishte evidentuar në protokollin e vetëlëndimeve. Pra, evidentimi mjekësor që është shumë i rëndësishme të rastet e lëndimeve, vdekjeve dhe vetëvrasjeve, nuk është profesional dhe nuk bëhet çdoherë sipas procedurave standarde.

Të burgosurit raportojnë se mjekët nuk qëndrojnë gjatë gjithë kohës brenda institucionit, sidomos është raportuar për konsulentët e jashtëm.

Mungesa e shërbimeve psikiatrike është evidente në QK Dubravë, ku vetëm një psikiatër i angazhuar në një institucion me mbi 600 të burgosur, shumica me nevoja specifike, është e pamundur që t'i përgjigjet të gjitha kërkesave të të burgosurve. Po ashtu, në QK Dubravë është i angazhuar vetëm një psikolog.

10. MENAXHIMI I PANDEMISË COVID-19

Njësitë shëndetësore bashkë me institucionet korrektuese, e kanë menaxhuar mjaftë mirë situatën me Pandeminë Covid-19 gjatë vitit 2021. Vaksinimi i stafit shëndetësor është bërë që në fillim të aplikimit të vaksinës, ndërsa vaksinimi i të burgosurve dhe stafit korrektues është bërë sipas prioritetëve dhe procedurave të caktuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Me arritjen e kontingjentit të parë me vaksina në Kosovë, në Qershor 2021 QKRMT i ka bërë thirrje Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) që kategoritë e veçanta, duke përfshirë të burgosurit t'i trajtojë me prioritet, mirëpo kjo thirrje QKRMT-së nuk u mor në konsideratë nga Ministria e Shëndetësisë, e cila aplikoi vaksinimin për të burgosurit sikurse për personat në liri, vetëm sipas prioritetëve të paracaktuara (të sëmurët kronik dhe sipas moshës).

Pas fillimit të vaksinimit të të gjithë popullatës, edhe të burgosurit vullnetarisht janë vaksinuar.

Masat kufizuese kanë ndryshuar varësisht prej rrethanave, rritjes së numrit të rasteve me Covid-19 dhe rekomandimeve të MSH dhe Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik. Në rastet kur është bërë ndërprerja e vizitave familjare, ato janë zëvendësuar me mundësinë e komunikimit përmes platformës Skype.

Nuk ka pasur ankesa për furnizim me maska, ndërsa furnizimi me dezinfektues ka qenë i mjaftueshëm në ambientet shëndetësore dhe në ambientet e administratës, por jo edhe në ambientet e banimit për të burgosurit.

11. PUNA E PANELIT PËR LIRIM ME KUSHT

Në mesin e çështjeve të ngritura vazhdimisht si shqetësim nga të dënuarit është funksionimi i Panelit për Lirim me Kusht (PLK). Ankesat kryesore të të dënuarve ndërlidhen me përmbajtjen e arsytimit të vendimeve të PLK-së dhe vonesat në shqyrtim dhe përgjigje. Arsyetimet janë kryesisht si modele/shabllon dhe shpesh nuk janë në përputhje me raportet pozitive të ofruara nga institucionet korrektuese ose beneficionet që gëzojnë të dënuarit si rezultat i sjelljes së tyre gjatë vuajtjes së dënimit. Vendimet e refuzimit të Panelit dominohen nga arsyeime të tilla si: *"qëllimi i dënimit nuk është arritur", "rrezik i lartë i veprës", "periudhë e gjatë e mbetur e dënimit", "procesi i risocializimit nuk ka përfunduar",* etj.

Nga praktika e monitorimit, QKRMT ka takuar të dënuar të cilët gjatë vuajtjes së dënimit kanë qenë të angazhuar në punë jashtë institucionit, mirëpo të njëjtit janë refuzuar nga PLK-ja me arsyetimin se nuk është arritur shkalla e risocializimit. Edhe pse iu është lejuar të dalin jashtë institucionit dhe të punojnë rregullisht, PLK-ja ka konstatuar se nuk është arritur një shkallë e mjaftueshme e risocializimit.

Lirimi me kusht është i paraparë me Kodin Penal si mundësi për të dënuarit që të lirohen nga vuajtja e dënimit, pa e vuajtur në tërësi dënimin e shqiptuar nga gjykata. Bazuar në LESP-in, Paneli për lirim me kusht përbëhet prej tre (3) anëtarëve: një (1) gjyqtar i Gjykatës Supreme, i deleguar nga Kryetari i Gjykatës Supreme; një (1) gjyqtar i Gjykatës së Apelit i deleguar nga Kryetari i Gjykatës së Apelit dhe një (1) gjyqtar i Gjykatës Themelore në Prishtinë, i deleguar nga Kryetari i Gjykatës Themelore. Paneli është kompetent për shqyrtimin e të gjitha kërkesave dhe propozimeve për lirim me kusht, në bazë të raporteve të përpiluara nga ekipet profesionale të institucioneve korrektuese të Kosovës.

Kundër aktvendimit të Panelit i cili funksionon në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nuk lejohet ankesa dhe nuk mund të ngritët konflikt administrativ. QKRMT vazhdimisht e ka ngritur si çështje shqetësuese faktin se vendimet e PLK-së kanë qenë përfundimtare dhe të dënuarve nuk u është lejuar e drejta në ankesë. Me draftin e ri të LESP-it është paraparë e drejta në ankesë ndaj vendimeve të PLK-së. Sipas draftit të Ministrisë së Drejtësisë *Pala e pa kënaqur me vendimin e PLK, ka të drejtë të ankohet ndaj vendimeve, drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimi të vendimit.* QKRMT e vlerëson pozitivisht propozimin e përfshirë, për të drejtën në ankesë ndaj vendimeve të PLK-së. Përveç që shkalla e dytë do ta kenë mundësinë e rivlerësimit të çështjes, e drejta në ankesë mund të ketë rezultat edhe në ngritjen e kualitetit dhe të efikasitetit të punës së PLK-së. Praktika e të drejtës për ankesë ndaj

vendimeve të Panelit për Lirim me Kusht përkrahet dhe promovohet edhe nga Këshilli i Evropës.⁴

QKRMT do të vazhdojë ta përcjellë me vëmendje këtë draft të LESP-it, për tu siguruar dhe avokuar se mundësia e ankimit të vendimit të PLK-së, do të mbetet edhe në versionin që pritet të miratohet në Kuvendin e Kosovës.

12. TRAJTIMI I TË MITURVE GJATË PRIVIMIT NGA LIRIA

Sistemi korrektues në Kosovë ka dy institucione për vendosjen dhe trajtimin e të miturve, të cilët kanë kryer apo dyshohet se kanë kryer vepra penale: 1] Qendra Korrektuese për të Mitur në Lipjan, dhe 2] Qendra Edukuese Korrektuese në Lipjan.

Në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan për një kohë të gjatë janë akomoduar kategori të ndryshme të personave të privuar nga liria, si të miturit e të dy gjinive në paraburgim, me dënime me burgim për të mitur dhe me masë edukative; femrat në paraburgim, femrat e dënuara; si dhe të dënuarit madhorë / kundërvajtës.

Në fund të vitit 2019, femrat e dënuara dhe të paraburgosura, si dhe të miturat janë transferuar në institucionin e veçantë, Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan, përkatësisht në objektin e ish-Qendrës së Paraburgimit në Lipjan.

Me qëllim të vendosjes dhe trajtimit të të miturve me masë edukative korrektuese, në vitin 2017 është inauguruar Qendra Edukuese Korrektuese [QEK], institucion i ri dhe i tipit të hapur me kapacitet prej 36 shtretërish. Me hapjen e këtij institucioni, gradualisht kishte filluar vendosja e të miturve me masë edukative korrektuese në këtë qendër, mirëpo deri më tani, asnjëherë

⁴ Rekomandimi Rec [2003] 22 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare me lirim me kusht, paragrafi 33 <<https://rm.coe.int/16800ccb5d>>

nuk janë shfrytëzuar të gjitha kapacitetet për vendosjen e të gjithë të miturve me masë edukative. Gjatë vitit 2021 ishin të vendosur vetëm 8 të mitur në QEK, përderisa numri prej mbi 20 të miturve me masë edukative vazhdojnë të qëndrojnë në Qendrën Korrektuese për të Mitur.

Kodi i Drejtësisë për të Mitur ka paraparë që *“Masa edukative e dërgimit në institucionin edukativ korrektues ekzekutohet në institucionin edukativ korrektues të themeluar për këtë qëllim. Institucioni edukativo korrektues është institucion korrektues i tipit gjysmë të hapur dhe të hapur.”*

Qendra Korrektuese dhe Qendra Edukuese Korrektuese administrohen nga i njëjti menaxhment. Sipas menaxhmentit të këtyre qendrave, vendosja e të miturve me masë edukative korrektuese në Qendrën Edukuese Korrektuese, bëhet vetëm pasi të miturit fillimisht vendosen në Qendrën Korrektuese dhe pasi t'i plotësojnë disa kriteret mund të kalojnë në Qendrën Edukuese Korrektuese.

Një ndër shqetësimet kryesore të evidentuara nga QKRMT është ***vendosja e të dënuarve madhorë në Qendrën Korrektuese për të Mitur***. Në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan, në një Pavijon të veçantë, gjatë vitit 2021 ishin të vendosur edhe të dënuarit madhorë. Kapaciteti i këtij Pavijoni është 20 shtretër. Në vizitën monitoruese të realizuar në muajin qershor 2021 numri i të dënuarve madhorë ishte 18, ndërsa në muajin nëntor 2021 ishin të vendosur 11 të dënuar madhorë.

Vendosja e të dënuarve madhorë në këtë qendër bëhej në bazë të Rregullores të Brendshme për *“Transferin e të dënuarve në pavijonin gjysmë të hapur në Qendrën Korrektuese në Lipjan,”* e nxjerrë në janar 2020 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës.

QKRMT vlerësoi se kjo Rregullore e cila përcakton kriteret për vendosjen e të dënuarve madhorë në Pavijonin gjysmë të hapur në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan, ishte nxjerrë në kundërshtim me ligjin në fuqi për ekzekutimin e sanksioneve penale. Neni 33 p.6 i Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale [LESP] përcakton si në vijim: *“Personat*

madhorë nuk vendosen në institucionin korrektues, ose në një pjesë të institucionit korrektues me të miturit”.

Kodi i Drejtësisë për të Mitur [neni 4, p.6] ndër parimet themelore për vendosjen dhe trajtimin e të miturve parasheh që *“çdo i mitur i privuar lirë ndahet nga madhorët, përpos nëse konsiderohet se është në interes të miturit të mos ndahet”*, ndërsa neni 100 p.1 përcakton që: *“Burgimi për të miturit mbahet në institucion korrektues për të mitur dhe, në raste të jashtëzakonshme, në pavijone të ndara të institucionit korrektues për persona madhor. Institucioni korrektues për të mitur është i llojit gjysmë të hapur. Përjashtimisht të miturit mund të mbajnë dënimin me burgim për të mitur në institucionin korrektues të tipit të mbyllur”*.

QKRMT nuk pajtohet me këtë praktikë të vendosjes së të dënuarve madhorë në Qendrën Korrektuese për të Mitur, përderisa nuk ka pasur asnjë rrethanë të jashtëzakonshme që do të arsyetonte vendosjen e të dënuarve madhorë në Qendrën Korrektuese për të Mitur. Për më tepër, QKRMT gjatë vizitës monitoruese në nëntor 2021, ka evidentuar 11 të dënuar madhorë për vepra të rënda penale si dhe më dënime të gjata deri në 25 vjet burgim [ndër ta të dënuar me **25, 17 dhe 12 vjet burgim**]. Ndërsa veprat për të cilat vuanin dënimin, që të gjitha ishin të natyrës së rëndë, ku më së shumti kishte të dënuar për **Vrasje/Vrasje të rëndë** dhe **Grabitje**, pastaj një rast për **dhunë në familje**, dhe një rast për **Keqpërdorim seksuale të personave nën 16 vjeç**.

QKRMT konsideroi se vendosja e të dënuarve madhorë për veprat më të rënda siç janë vrasjet dhe grabitjet është e pa pranueshme dhe në kundërshtim me çdo standard për trajtimin e të miturve. Për më tepër, vendosja e një të dënuari me **7 vjet burgim** për veprën penale **“Keqpërdorim seksuale të personave nën 16 vjeç”** është në kundërshtim me të gjitha parimet për trajtimin e të miturve në institucionet korrektuese.

Fillimisht, QKRMT ka kërkuar në nivel të institucionit dhe Shërbimit Korrektues që të rishikohet kjo procedurë sepse nuk ishte në harmoni me dispozitat ligjore, mirëpo nga menaxhmenti i Qendrës Korrektues për të

Mitur ka njoftuar QKRMT-në, që kjo çështje është adresuar për ndryshime ligjore dhe kanë propozuar që në draftin e ri të LESP të rregullohet kjo çështje me qëllim që të mundësohet me ligj vendosja e të dënuarve madhorë në Qendrën Korrektuese për të Mitur, pasi që për nevojat e institucionit është e nevojshme që të vendosen disa të dënuar madhorë [për arsye të angazhimit në punë].

Më pastaj, QKRMT ka adresuar edhe një letër për Shërbimin Korrektues dhe Ministrinë e Drejtësisë, mbi nevojën e rishikimit të procedurave për transferimin e të dënuarve madhorë në Qendrën Korrektuese për të Mitur dhe shfuqizimin e rregullores me anë të së cilës bëhet ky transferim, pasi që kjo rregullore është në kundërshtim me nenin 33 para. 6 të LESP.

- Dispozita ligjore aktuale në fuqi, Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale [LESP]:

Vendosja e personave të dënuar në institucionet korrektuese Neni 33 paragrafi 6: *“Personat madhorë nuk vendosen në institucionin korrektues, ose në një pjesë të institucionit korrektues me të miturit”.*

- Propozim-ndryshimi nga ShKK dhe Ministria e Drejtësisë në **draftin e LESP** të finalizuar nga Ministria e Drejtësisë [tetor 2021]:

Vendosja e personave të dënuar në institucionet korrektuese Neni 13 paragrafi 5: *“Personat madhorë nuk vendosen në institucionin korrektues, ose në një pjesë të institucionit korrektues me të miturit, përjashtimisht personat madhor mund të vendosen në një pjesë të veçantë të Institucionit korrektues për të mitur të cilët kryejnë punë të natyrës specifike ose punë të rënda për nevoja të Institucionit, të cilat punë të miturve nuk u lejohet që t’i kryejnë”.*

Lidhur me këtë propozim-ndryshim, QKRMT ka dorëzuar komentet dhe arsyetimet në zyrën ligjore të Ministrisë së Drejtësisë, dhe ka kërkuar që kjo

dispozitë të riformulohet, mirëpo një propozim i tillë është refuzuar nga zyra ligjore/grupi punues për hartimin e LESP.

QKRMT do të avokojë në të gjitha fazat e ndryshimit të ligjit, që kjo dispozitë mos të aprovohet si e tillë, me qëllim të parandalimit të vendosjes së të dënuarve për vepra të rënda penale në Qendrën Korrektuese për të Mitur.

Sa i përket arsyetimit të Shërbimit Korrektues dhe Ministrisë së Drejtësisë, që transferimi i të dënuarve madhorë në Qendrën Korrektuese për të Mitur bëhet me qëllim të angazhimit të tyre në punë të rënda për nevojat e institucionit, në praktikë kjo nuk ndodhë, pasi që në bazë të monitorimit të të gjitha institucioneve korrektuese në Kosovë, QKRMT ka evidentuar se përkundër vendosjes së të dënuarve madhorë në këtë qendër, punët e rënda dhe specifike janë kryer nga të burgosur të tjerë të cilët janë sjellë prej institucioneve të tjera korrektuese për t'i përfunduar këto punë.

13. ADRESIMI I NDRYSHIMEVE LIGJORE

Përveç aspektit të monitorimit të institucioneve korrektuese, QKRMT është e angazhuar dhe avokon për ndryshimin e legjislacionit relevant. Kësisoj, edhe gjatë vitit 2021 QKRMT është angazhuar vazhdimisht, që kërkesat e të burgosurve si dhe standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare të reflektojnë në ligjet relevante.

Gjatë vitit 2021, Ministria e Drejtësisë dhe ShKK kanë qenë në proces të hartimit dhe plotësim-ndryshimit të kornizës legjislative lidhur me institucionet korrektuese. Draft ligji i ri për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe draft ligji për Shërbimin Korrektues kanë qenë dy nismat kryesore të vitit 2021. Edhe pse kanë qenë të planifikuara që të përfundojnë gjatë 2021, të dy këto ligje janë bartur për vitin 2022.

Në komentet e adresuara për LESP-in, QKRMT mes tjerash ka avokuar që të rikthehen për të burgosurit beneficionet që i kanë pasur me ligjin e vitit 2013, siç janë ditët shtesë jashtë institucionit korrektues.

Në fokus të kontributit të QKRMT-së ka qenë rregullimi i çështjes së vendosjes dhe trajtimit së të dënuarve dhe të paraburgosurve me çrregullime mendore. Përmes shkresave drejtuar institucioneve përkatëse, si dhe deklaratave publike, QKRMT ka avokuar që kjo çështje të adresohet dhe të ndërmerren veprimet e nevojshme për zgjidhjen e këtij problemi.

Për më tepër, QKRMT ka ofruar komentet edhe për çështjen e Njesisë Ekonomike, për metodat e informimit për të burgosurit, për procedurën e ankesave, tek përdorimi i forcës dhe mjeteve shtrënguese, tek përbërja dhe kompetencat e PLK-së. Lidhur me draftin e ri të LESP-it, QKRMT ka sugjeruar që MD-ja të rregullojë edhe mbikëqyrjen elektronike, si formë alternative të mbikëqyrjes ndaj personave me liri të kufizuar me vendim gjyqësor.

Duke u bazuar në mandatin dhe veprimtarinë e QKRMT-së, është thelbësore trajtimi adekuat dhe menaxhimi në mënyrën më të mirë i personave të privuar nga liria. Kjo mund të arrihet atëherë kur Shërbimi Korrektues e arrin nivelin e nevojshëm të avancimit, si në aspektin e kushteve materiale, ashtu edhe në aspektin e burimeve njerëzore profesionale. Për këtë qëllim ka qenë interes i veçantë i QKRMT-së ofrimi i komenteve edhe për projektligjin për Shërbimin Korrektues të Kosovës. Është hera e parë që ShKK do të ketë një ligj të veçantë, përmes të cilit do të përcaktohen specifikat e strukturave të ShKK-së dhe do të rregullohet statusi i zyrtarëve korrektues dhe stafit tjetër.

14. MARRËVESHJA PËR DHËNIEN ME QIRA TË QENDRËS SË PARABURGIMIT NË GJILAN

Gjatë muajit dhjetor 2021, Ministria e Drejtësisë ka njoftuar që janë duke i zhvilluar diskutimet me Qeverinë e Mbretërisë së Danimarkës për dhënie me qira të Qendrës së Paraburgimit në Gjilan. Ministria e Drejtësisë ka

nënshkruar një letër qëllim e cila do t'i paraprijë negociatave për Marrëveshjen e cila pritet të nënshkruhet nga Ministria e Drejtësisë së Republikës së Kosovës me Mbretërinë e Danimarkës për transferimin e 300 të burgosurve nga burgjet daneze në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan.

QKRMT ka adresuar disa shqetësime lidhur me këtë marrëveshje, të cilat mund të paraqesin implikime gjatë zbatimit të asaj marrëveshje, lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut.

QKRMT ka vlerësuar që përkundër përmirësimeve të kushteve të vendosjes në vitet e fundit pas hapjes së tri institucioneve të reja korrektues (Burgut të Sigurisë së Lartë, Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë dhe Qendrës së Paraburgimit në Gjilan), me vendosjen e 300 të burgosurve nga Danimarka në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, risistemimi i 200 të burgosurve që momentalisht gjenden në këtë Qendër, do të rezultonte në mbipopullimin dhe përkeqësimin e kushteve në qendrat tjera korrektuese.

Sipas Ministrisë së Drejtësisë, brenda Shërbimit Korrektues të Kosovës ka kapacitete të mjaftueshme për të akomoduar edhe përafërsisht 700-800 të burgosur dhe të paraburgosur, mirëpo sipas gjetjeve të QKRMT-së në bazë të vizitave të rregullta monitoruese jo të gjitha vendet e lira në institucionet korrektuese janë funksionale. Hapësirat e mundshme që mund të identifikohen brenda shërbimit korrektues duhet të vlerësohen në bazë të kategorisë së të burgosurit përpara se të bëhet një transferim i tillë, pasi që vendet e lira në institucionet korrektuese, të cilave iu referohet Ministria e Drejtësisë janë brenda institucioneve specifike, gjë që është e pamundur që të transferohen të paraburgosurit nga Qendra e Paraburgimit në Gjilan.

Gjithashtu, QKRMT kërkoi debat të gjerë publik rreth kësaj Marrëveshje për të diskutuar implikimet ligjore dhe të sovranitetit që ndërlidhen me juridiksionin ekstraterritorial të autoriteteve daneze në vendin tonë.

QKRMT konsideron se institucionet e Kosovës, së bashku me partnerët e saj ndërkombëtarë, kanë punuar shumë për të përmirësuar kushtet e burgjeve

dhe për ta afruar atë me standardet ndërkombëtare. Për këtë arsye, Qeveria e Kosovës duhet të marrë parasysh shqetësimet e ngritura nga organizatat e të drejtave të njeriut dhe të sigurohet që nënshkrimi i kësaj marrëveshje dypalëshe nuk do t'i bënte dëm progresit drejt avancimit të të drejtave të njeriut në Kosovë.

QKRMT ka bërë një analizë ligjore rreth kësaj marrëveshje, e cila bashkë me kontributet e ekspertëve ndërkombëtarë dhe vendorë, Mekanizmit Kombëtar Norvegjez për Parandalimin e Torturës, Instituti Danez Kundër Torturës, si dhe institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës, është publikuar veçmas. Gjithashtu, rekomandimet e kësaj analize janë ndarë me të gjithë akterët relevant.

15. AVOKIMI DHE NDIHMA LIGJORE E QKRMT-SË

Me qëllim të mbrojtjes dhe avancimit të të drejtave të personave të privuar nga liria, QKRMT ka ndërmarr aktivitete avokuese, si për rastet individuale, njashtu edhe për ndryshimin e politikave në nivele institucionale.

Rastet e shkeljeve individuale të evidentuara gjatë vizitave monitoruese apo pas raportimit përmes kanaleve të tjera, janë adresuar tek organet kompetente, dhe është kërkuar trajtimi i duhur i këtyre rasteve.

Përmes marrëveshjes së Mirëkuptimit me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, monitoruesve të QKRMT ju lejohet qasja në monitorimin e seancave gjyqësore në të gjitha gjykatat e Kosovës. Kështu, gjatë vitit 2021, QKRMT ka realizuar monitorime të fokusuara në gjykatat e Kosovës, përkatësisht janë monitoruar ato raste që kanë qenë me paraburgim të gjatë. QKRMT ka evidentuar shumë raste ku proceset gjyqësore zgjasin me vite të tëra, duke ndikuar kështu drejtpërdrejtë edhe në kohëzgjatjen e masës së paraburgimit. Shqetësuese mbeten rastet që kthehen disa herë në rigjykim, ku statusi i personave të privuar nga liria mbetet *“i paraburgosur”*, me ç'rast ata përjashtohen nga të drejtat që u takojnë personave të dënuar.


QKRMT ka monitoruar në vazhdimësi procesin gjyqësor ndaj të pandehurit [Sh.Z], rast ky i cili është kthyer në rigjykim mbi 5 herë, përkatësisht procesi gjyqësor ka filluar që nga viti 2009 dhe ende është pa epilog. I pandehuri fillimisht është dënuar me 10 vjet burgim për veprën penale “shtytje në vrasje”, ndërsa më vonë gjatë rigjyimeve është dënuar me 8 vjet burgim për “ndihmë në vrasje”. I pandehuri i ka mbajtur 6 vjet paraburgim dhe rreth një vit dënim, pastaj në vitin 2020 është liruar me kusht. Pasi që është liruar me kusht, në qershor 2021 pas shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme ka vendosur që rastin ta kthejë në rigjykim. Pra, për më tepër se 12 vjet rasti vazhdon të endet nga njëra gjykatë në tjetrën, pa pasur një përfundim. QKRMT ka mbështetur këtë rast përmes shkresave avokuese dhe ka monitoruar seancat gjyqësore.

QKRMT ka vazhduar komunikimet me autoritetet gjyqësore çdo herë kur ka pasur ankesa dhe shqetësime nga të burgosurit. Komunikim të vazhdueshëm avokues QKRMT ka pasur edhe me institucionet korrektuese dhe DShB.

Gjithashtu, të gjitha ankesat dhe shqetësimet që ka pranuar QKRMT lidhur me punën e Panelit për Lirim me Kusht, janë adresuar në këtë Panel. Kryesisht ankesat për mos njoftim rreth statusit të lëndëve, mungesën e vendimeve etj..

Sa i përket avokimit publik, QKRMT ka adresuar shkresa publike tek institucionet përkatëse, të pasuara me komunikata për media. Gjithashtu, janë organizuara tryeza diskutimi për të adresuar dhe avokuar për çështje specifike, që kanë të bëjnë me shëndetin mendor dhe trajtimin e të miturve.

GJETJET NGA MONITORIMI I INSITUCIONEVE KORREKTUESE



1. QENDRA KORREKTUESE NË DUBRAVË

Ekipi monitorues ka vizituar Qendrën Korrektuese [QK] në Dubravë në datat: 2 shtator, 6 tetor dhe 21 dhjetor 2021.

Qendra Korrektuese në Dubravë përbëhet nga 11 Pavijone, prej të cilëve:

- 6 pavijone standarde për të dënuar;
- pavijoni për të dënuarit me nevoja të veçanta;
- pavijoni për të dënuarit për terrorizëm;
- pavijoni i Spitalit;
- pavijoni gjysmë i hapur, dhe
- pavijoni D që është ndërtuar me qëllim të vendosjes së dëshmitarëve të mbrojtur por që tani ka ndërruar qëllimin dhe është duke u rinovuar dhe përshtatur për vendosjen e personave me çrregullime mendore dhe me nevoja të veçanta.

Kapaciteti me shtretër në QK Dubravë është rreth 1100. Dhomat standarde janë me nga 4 dhe 6 shtretër, ndërsa dhomat e vetmisë me nga një shtrat.

Në vitet e kaluara numri i të dënuarve në këtë institucion sillet rreth 900-1000 të dënuar, ndërsa për herë të parë gjatë vitit 2021 ka pasur një rënie të theksuar të dënuarve, ku gjatë vizitës monitoruese në muajin shtator ishin 580 të dënuar ndërsa në muajin dhjetor ishin 660 të dënuar. Kjo rënie e numrit të të dënuarve ka ardhur pasi që Pavijoni 2 është jashtë funksionit për shkak të nevojës për renovim, gjithashtu pavijoni D është jashtë përdorimit, si dhe fakti që viteve të fundit nuk janë vendosur të paraburgosurit, pasi që është Qendër Korrektuese është dedikuar vetëm për të dënuar.

QK Dubravë në vazhdimësi është përballur me paqëndrueshmërinë e menaxhmentit. Drejtorët e kësaj qendre janë ndërruar vazhdimisht, kryesisht

për shkak të procedurave disiplinore apo hetimore ndaj tyre, por edhe për arsye të transfereve apo ndërrimeve. Edhe këtë vit, kjo Qendër nuk ka pasur drejtor me kompetenca të plota por vetëm ushtrues detyre.

Mungesa e menaxhmentit funksional me kompetenca dhe përgjegjësi të plotë, ndikon drejtpërsëdrejti në menaxhimin e institucionit duke përfshirë edhe trajtimin e të burgosurve.

Qendra Korrektuese në Dubravë mbetet qendra me më së shumti probleme në menaxhimin dhe trajtimin e të dënuarve.

Numri i stafit nuk është në proporcion me nevojat e institucionit, pasi që vendet të cilat kanë mbetur të zbrazëta nuk janë zëvendësuar me staf të ri (rastet e pensionimit, të vdekjeve, apo të atyre që e kanë ndërprerë marrëdhënien e punës).

Mosha mesatare e stafit korrektues në QK Dubravë është mbi 51 vjeç. Kjo rezulton edhe me pamundësinë e kryerjes së detyrave të tyre në mënyrën më të mirë. Sipas menaxhmentit, por edhe nga stafi korrektues, projektligji për ShKK-në nuk e përmirëson gjendjen e tyre.

Një zhvillim pozitiv në QK Dubravë është edhe fillimi me përgatitjen e planit individual për të dënuarit. Në muajin shtator ka filluar punën Paneli për vlerësimin dhe përgatitjen e planeve të tilla. Ky Panel ka në përbërje udhëheqësin e programeve dhe regjimeve, udhëheqës të Pavionit në të cilin gjendet i dënuari, mbikëqyrësi i punëtorëve social, punëtori social i angazhuar me të dënuarin, koordinatori për punësim, zyrtarë të sigurisë dhe anëtarë tjerë sipas nevojës.

Ekipi monitorues në realizimin e intervistave me të burgosur qoftë gjatë vizitave monitoruese, apo përmes telefonit dhe letrave të ndryshme, ka pranuar ankesa të vazhdueshme nga të burgosurit në QK Dubravë. Ankesat e të burgosurve kryesisht ndërlidhen me sjelljet e stafit, shërbimet shëndetësore, kualitetin e ushqimit, punën e PLK-sw, etj.

QK Dubravë vazhdon të përballët me problemin e akomodimit të të burgosurve me probleme mendore dhe përdoruesve të substancave

narkotike. Për shkak të mungesës së ambienteve adekuate për vendosjen e këtyre kategorive, këto grupe janë të vendosura në ambientet e QK Dubravë.

Sa i përket trajtimit, të burgosurit pohojnë se ka raste kur ofendohen nga oficerët korrektues, po ashtu edhe raste të përdorimit të forcës. Zakonisht menaxhmenti nuk i raporton rastet e tilla. QKRMT ka marrë disa pohime të tilla, të cilat janë evidentuar në evidencat mjekësore. QKRMT e ka monitoruar njërin ndër rastet për pohim të keqtrajtimit, por QK Dubravë dhe Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë kanë deklaruar se përkundër pretendimit të të burgosurit, nuk është përdorur dhunë ndaj tij. I burgosuri rastin e ka paraqitur edhe në Polici të cilët më pas e kanë intervistuar. Sipas përgjigjeve të menaxhmentit dhe Inspektoratit, nuk është vërtetuar përdorimi i forcës, ndërsa sipas këtyre raporteve hetimi i këtij rasti ka përmbytur të dhëna rreth veprimeve paraprake të të burgosurit e jo për përdorimin e dhunës. Pas, fillimit të trajtimit të këtij rasti, i burgosuri është transferuar në një institucion tjetër korrektues.

Transferimi i të burgosurve pas incidenteve të tilla është i zakonshëm, ku sipas të burgosurve të intervistuar kjo bëhet me qëllim që të humbin gjurmët si dhe të shkaktohet frikë te të burgosurit. Raste të përdorimit të forcës fizike kishte të evidentuar edhe në dosjet mjekësore.

Rastet e përleshjeve fizike mes të burgosurve janë evidente në QK Dubravë. Rastet të tilla ka të evidentuara edhe në dosjet dhe protokollet mjekësore.

Kontrabanda mbetet e pranishme në QK Dubravë. Gjatë vitit të fundit kjo qendër është pajisur me skaner dhe detektor, të cilët do të rrisin nivelin e sigurisë dhe mund të ndikojnë në parandalimin e kontrabandës. Me anë të këtyre skenerëve, së fundmi në QK Dubravë ishte zënë një zyrtar korrektues duke tentuar futjen e kontrabandës brenda institucionit.

Gjithashtu është pohuar për trajtim sipas standardeve të dyfishta, ku sipas të burgosurve vazhdon të ketë dallim mes tyre sa i përket realizimit të beneficioneve. Sidomos raportohet për rastet e transfereve, të cilat iu

mundësohen vetëm të dënuarve që kanë lidhje apo që këto beneficione i realizojnë përmes korrupsionit.

Shqetësuese vazhdon të mbetet trajtimi që ju bëhet të burgosurve me probleme mendore. Stafi korrektues nuk e ka përgatitjen e nevojshme për trajtimin e kësaj kategorive, kurse edhe kushtet e vendosjes janë jo-adekuate për nevojat e tyre. Monitoruesit e QKRMT-së kanë evidentuar se në Pavijonin 7, të sëmurë organik janë të vendosur bashkë me të burgosur me probleme mendore. Të dënuar me probleme mendore kishte të vendosur gjithandej pavijoneve në QK Dubravë.

Po ashtu, në QK Dubravë gjendet një numër i konsiderueshëm i të burgosurve përdorues të substancave narkotike. Sipas menaxhmentit, numri i të burgosurve përdorues të narkotikëve është në rritje kohëve të fundit, nga ta 20 të burgosur ishin në programin e metadonit.

Të burgosurit e intervistuar paraqitën shqetësime ndaj procedurës së ankesave. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të tyre zgjatë shumë, madje, sipas të burgosurve, ka raste kur kërkesat e tyre nuk përcillen fare tek drejtorja e QK Dubravë. Kishte pohime se për disa çështje frikësohen që të ankohen, për shkak të rrezikut për hakmarrje nga zyrtarët korrektues. Mekanizmi i ankesave nuk siguron konfidencialitet, andaj edhe të dënuarit pohojnë që nuk i aplikojnë formularët e ankesave pasi që janë formularë të hapur.

Të dënuarit kanë paraqitur shqetësime ndaj punës së Panelit për Lirim me Kusht [PLK], dhe kanë ankesa ndaj shqyrtimit që ju bëhet kërkesave të tyre, siç janë përgjigjet e vonuara të PLK-së, etj. Një pjesë e të burgosurve ankoheshin për diskriminim nga Paneli për Lirim me Kusht dhe për mos përfillje të rregullave ligjore rreth lirimit me kusht.

Në mesin e të dënuarve ka edhe persona të cilët janë me kategori të rrezikshmërisë. Marrë parasysh numrin jo të mjaftueshëm të stafit korrektuese dhe moshën mesatare, kjo kategori paraqet sfidë për menaxhim

në këtë qendër. Sa i përket vlerësimit të rrezikshmërisë, raportet pozitive që përgatitën nga stafi i QK Dubravë, nuk merren parasysh mjaftueshëm nga Drejtoria Qendrore. Edhe të dënuarit me kategori u ankuan se vlerësimi ju vonohet, përdoren arsyetime shabllon, etj.

QK Dubravë vitin e fundit është furnizuar me dyshekë anti-zjarr, batanije e jastëk. Dyshekët dhe batanijet kanë qenë shumë të dëmtuara dhe të vjetra, të cilat kanë paraqitë rrezik për mirëqenien e të burgosurve. Kjo situatë tashmë është përmirësuar dhe QKRMT e ka mirëpritur këtë investim në përmirësimin e kushteve të akomodimit. Megjithatë, Pavijoni Gjysmë i Hapur [PGjH] nuk është përfshirë në këtë projekt, nuk janë furnizuar me dyshek të rinj, dhe kështu ende janë në përdorim dyshek shumë të vjetër.

Aktualisht Pavijoni 2 është jashtë funksionit, për shkak të dëmtimeve si pasojë e rrjedhjes së ujit. Ky pavijon është planifikuar që të rinovohet gjatë vitit 2022.

Për shkak të zvogëlimit të numrit të të burgosurve në këtë qendër, nëpër dhoma janë të vendosur maksimumi nga 4 persona. Kështu që nuk ka mbingarkesë dhe vendosja e të burgosurve mund të bëhet në mënyrë më të mirë, duke respektuar kriteret për hapësirën e nevojshme fizike.

QKRMT vlerëson se në disa pavijone kushtet e banimit mbesin nën standarde. Disa nga dhomat nëpër pavijone janë mjaft të dëmtuara dhe ka defekte në nyjat sanitare dhe ato elektrike. Po ashtu, vërehej lagështi në ambientet e banimit dhe në hapësirat e përbashkëta. Pavijoni 3 dhe 5 kanë kushtet më të dobëta materiale, ku dyshemeja është shumë e dëmtuar nëpër korridore dhe në dhomat e të dënuarve. Gjithashtu, në PGjH ekipi monitorues ka vërejtur se gjendja materiale e banjave është mjaftë e dobët, sidomos ajo në katin e dytë ku kishte vazhdimisht rrjedhje të ujit dhe ishte formuar lagështi në disa pjesë të mureve.

Të burgosurit kanë paraqitur ankesat e tyre me furnizimin e produkteve higjienike sa i përket sasisë dhe cilësisë së tyre.

Po ashtu, shqetësuese mbetet mungesa e ujit të ngrohtë në disa pavijone. Të burgosurit vazhdojnë ta ngrohin ujin për pastrim me mjete alternative por jo adekuate, forma këto që paraqesin rrezik për jetën e tyre.

Të burgosurve iu shërbehen 3 shujta gjatë ditës. Nga të burgosurit kishte ankesa rreth ushqimit, si për mënyrën e përgatitjes po ashtu edhe për cilësinë e dobët. Të punësuarit në kuzhinë nuk kishin uniforma të punës.

Të dënuarit në QK Dubravë kanë mundësinë e zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme. Organizohet mësimi dhe trajnimi të ndryshme. Në fillimin e vitit të ri shkollor, 60 të dënuar kanë aplikuar për ndjekjen e mësimëve në shkollën e mesme. Sa i përket trajnimeve profesionale, ofrohen këto drejtime: instalues të ujit dhe kanalizimit, axhustator, ndërtimtari, kuzhinier, teknologji informative, etj.

Po ashtu një numër i të dënuarve janë të angazhuar në punë brenda dhe jashtë pavijoneve, duke filluar nga angazhimi në pastrim, kuzhinë, fermë dhe bujqësi etj. Gjatë vizitës monitoruese (06.10.2021), 288 të dënuar ishin të angazhuar në punë të ndryshme brenda QK Dubravë. Po ashtu, sipas rutinës të burgosurit kanë mundësinë e realizimit të aktiviteteve të ndryshme sportive.

Kontakti me botën e jashtme organizohet përmes vizitave nga familja, telefonatat, skype [gjatë kufizimit të vizitave familjare për shkak të Pandemisë Covid-19], si dhe shfrytëzimi i ditëve të vikendit në familje.

Ndër kërkesat e vazhdueshme mbetet shtimi i numrit të ditëve të vikendit ashtu siç kanë qenë me ligjin paraprak, pasi që me plotësimin dhe ndryshimet e Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale në vitin 2017, të burgosurve u janë reduktuar numri i ditëve të vikendit në 7 ditë. Me këto ndryshime ligjore, të burgosurve u është ndaluar edhe pranimi i pakove ushqimore me arsyetimin se po futej kontabandë, por që edhe pas këtij kufizimi kontrabanda ka vazhduar të jetë prezentë në këto institucione.

Të burgosurit kanë bërë shumë greva e peticione për kthimin e ditëve të vikendit dhe lejimin e pakove ushqimore. QKRMT ka paraqitur rekomandimet e saj për përfshirjen e këtyre beneficioneve në projektligjin e ri për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Gjithashtu, ekipi monitorues ka monitoruar hapësirat e Pavijonit të Spitalit, si dhe ka biseduar me të burgosurit rreth ofrimit të shërbimeve shëndetësore. Sa i përket stafit të NjShB në QK Dubravë, gjatë 2021 i janë shtuar edhe një psikolog dhe dy infermierë. Risi tjetër është furnizimi me aparaturë për analiza të gjakut si dhe me aparaturë të re për matjen e parametrave vital. Gjendja në farmaci ka qenë e mirë. Shumica e barnave të nevojshme ishin në sasi të mjaftueshme.

QK Dubravë, këtë vit ishte e pajisur me aparaturë përkatëse dhe funksionale, si dhe e furnizuar mjaftueshëm me produktet mjekësore.

Në QK Dubravë, të burgosurit kanë vazhduar të adresojnë një numër të ankesave në drejtim të stafit shëndetësor që kanë të bëjnë me: mos ofrimin e shërbimeve shëndetësore me kohë, neglizhencën e stafit, humbjen e terminit. Ankesa të veçanta u adresuan për mungesë të ofrimit adekuat të shërbimeve stomatologjike.

Protokollet mjekësore nuk mbaheshin çdoherë mirë dhe me rregull. Ekipi monitorues gjeti raste që nuk janë evidentuar sipas rregullave, përkatësisht evidentimi i rasteve ishte i mangët.

2. BURGU I SIGURISË SË LARTË NË GËRDOC [BSL]

Ekipi monitorues ka vizituar Burgun e Sigurisë së Lartë në Gërdoc [BSL] në datat: 11 shkurt dhe 23 dhjetor 2021.

BSL është institucioni i vetëm i sigurisë së lartë në Kosovë, ku vendosen të dënuar dhe të paraburgosur të cilët janë të kategorizuar me rrezikshmëri të lartë apo me rrezikshmëri shumë të lartë. Po ashtu, parashihet që në këtë institucione të vendosen të dënuarit me mbi 15 vjet burgim.

Kapaciteti i këtij institucioni është 390 shtretër, ndërsa numri i të burgosurve gjatë vizitës së fundit ishte 171, nga të cilët 136 të dënuar dhe 35 të paraburgosur.

Në aspektin e kushteve materiale, BSL ka kapacitete për akomodimin e një numri edhe më të madh të të burgosurve, mirëpo nuk ka staf të mjaftueshëm. BSL ka të angazhuar 175 anëtarë të stafit, që përfshinë oficerët korrektues dhe zyrtarët civil, ndërsa janë në proces që të pranohen edhe 10 oficerë korrektues.

Përveç të dënuarve me dënime të larta, në BSL janë të vendosur edhe të burgosur për veprën penale të terrorizmit. Në ditën e vizitës monitoruese [23.11.2021], në BSL gjendeshin gjithsej 19 persona nga kjo kategori, nga të cilët 7 ishin në paraburgim. Të burgosurit e kësaj kategorie janë të vendosur ndaras nga pjesa tjetër e të burgosurve. Për këtë kategori në dispozicion janë programe të veçanta rehabilituese, ndërsa pjesëmarrja është vullnetare. Këto programe realizohen nga ekipe multi-disiplinare të përbëra nga punëtor social, psikologë, zyrtarë korrektues, në bashkëpunim me ICITAP [Programi Ndërkombëtar i Ndihmës për Trajnimin Hetimor Penal] dhe Këshillin e Evropës.

Aspekti i parandalimit të dukurive si kontrabanda vlerësohet si i suksesshëm. Ka raste shumë të rralla kur detektohet tentimi për futje të kontrabandës. Siguria në BSL vazhdon të jetë në nivel të kënaqshëm dhe e menaxhueshme.

Edhe në BSL nuk ka pasur menaxhment (drejtor) të qëndrueshëm. Pozita e drejtorit ka kohë që funksionon me ushtrues detyre, apo zëvendësues, ku gjatë vitit 2021 janë ndërruar dy zëvendësues.

Gjatë monitorimit, vëmendje e posaçme QKRMT i kushtoi trajtimit që ju bëhet të burgosurve, duke filluar nga kategorizimi dhe regjimet e të dënuarve, shërbimet sociale që ju ofrohen si dhe sjellja e stafit korrektues, me theks të veçantë keqtrajtimit eventual, qoftë fizik apo psikik. Nga monitorimi i realizuar në BSL, QKRMT ka pranuar ankesa dhe pohime nga të burgosurit për keqtrajtim nga stafi korrektues. Gjithashtu, janë evidentuar konfliktet mes të burgosurve, duke përfshirë edhe përleshjet fizike.

QKRMT ka evidentuar një rast të pohimit për keqtrajtim në BSL. I paraburgosuri pohoi se pas transferit nga QP Prizren për në BSL, në hapësirat e pranimit të të burgosurve është keqtrajtuar fizikisht nga stafi korrektues i BSL.

QKRMT ka shikuar dosjen mjekësore të këtij të paraburgosuri, dhe në bazë të dosjes është evidentuar se i njëjti ka pësuar lëndime si pasojë e dhunës fizike të ushtruar ndaj tij. I paraburgosuri është ankuar se nuk i është lejuar që t'i kontaktojë institucionet përkatëse me qëllim të raportimit të rastit. Këtë rast QKRMT e ka adresuar te menaxhmenti i BSL dhe Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë.

Trajtimi i personave me çrregullime mendore mbetet sfiduese edhe për këtë institucion. Një person me çrregullime mendore ka tentuar të bëjë vetëvrasje duke e djegur dhomën e tij. Reagimi i stafit korrektues ka qenë mjaft efikas ku kanë arritur ta parandalojnë vetëvrasjen, po ashtu shërbimi shëndetësor ka reaguar menjëherë. I paraburgosuri ka pësuar djegie të shkallës së dytë, dhe i njëjti është trajtuar në QKUK, dhe më pas është vendosur në IPFK. Vendosje e personave me çrregullime mendore në institucionet korrektuese është vështirë e menaxhueshme, ku në raste të tilla përveç tentativës për të kryer vetëvrasje, të njëjtit rrezikojnë edhe jetët e të burgosurve të tjerë dhe stafit të institucioneve.

Sa i përket kushteve materiale, BSL kryesisht ofron një nivel të kënaqshëm për vendosjen e të burgosurve. Të burgosurit janë të vendosur në dhoma njëshe. Megjithëkëtë, kishte hapësira të dëmtuara në infrastrukturën banuese. Kati i parë i Pavijonit 2 është më dobët sa i përket kushteve materiale. Dyshemeja është shumë e dëmtuar në këtë hapësirë. Ndërsa kati i dytë i këtij Pavijoni ishte jashtë funksionit, për shkak se ishte në renovim. Vitin e fundit edhe BSL është furnizuar me dyshekë të rinj.

BSL gjatë vitit 2021 ka qenë duke i zhvilluar punimet për rregullimin e mbulojës në shëtitore. Shëtitoret nuk kanë pasur mbulesë dhe në rast të shiut apo borës, të burgosurit ose nuk kanë dalë fare në shëtitje ose kanë dalë dhe kanë qëndruar në ambient të hapur. Andaj, hapësirat me mbuloja në shëtitore do ta përmirësonin këtë aspekt.

Ambienti i kuzhinës është i mirëmbajtur dhe të gjitha pajisjet ishin funksionale. Të dënuarit ishin kryesisht të kënaqur me ushqimin që ju shërbehet. Rreth 30 të burgosur ishin me regjim të ushqimit, me rekomandim të mjekut. Nga stafi i kuzhinës u tha se është mjaft sfiduese ky numër i madh i të burgosurve me regjim ushqimi, megjithatë janë duke u munduar që t'i zbatojnë rekomandimet e mjekëve.

Numri i të burgosurve të angazhuar në punë në BSL vazhdon të jetë mjaft i lartë. Në ditën e vizitës monitoruese në nëntor 2021, 89 të dënuar ishin të angazhuar në punë. Të dënuarve u mundësohet të punojnë në punëtoritë për prodhimin e letrës së tualetit, qeseve, produkteve të drurit, renovimet e ambienteve të institucionit, pastrim kuzhinë, etj. BSL i furnizon qendrat tjera korrektuese me letër tualeti, e në raste të caktuara edhe me punime nga druri, siç janë tavolinat.

Është për t'u vlerësuar angazhimi i një ekipi të dënuarve në BSL, të cilët kanë kryer trajnime dhe janë specializuar në punën me epoksid (për shtrimin e dyshemeve). Aktualisht në këtë ekip janë 4 të dënuar, të cilët përveç që kanë kryer punë shumë kualitative në BSL, gjithashtu janë angazhuar edhe nëpër qendrat e tjera, përfshirë QK për të Mitur në Lipjan. Këta të dënuar i kanë kryer disa renovime në QK Lipjan, duke udhëtuar çdo ditë. Në mëngjes janë dërguar

në QK Lipjan, e në mbrëmje janë kthyer në BSL. Kjo është një nga praktikat e mira e cila mund të përdoret edhe në rastet e tjera kur nevojitet angazhimi i të dënuarve në punë, në mënyrë që të evitohet praktika jo e mirë e vendosjes së të dënuarve me dënime të gjata në QK Lipjan, me qëllim të kryerjes së punimeve të caktuara.

Sipas planifikimeve, ky ekip shumë shpejt pritet të angazhohet në QK Dubravë, për të kryer punime me epoksid. Të dënuarit e punësuar vazhdojnë të paguhet me vetëm nga një [1] Euro në ditë. Duke marrë parasysh punën e madhe dhe kualitative që kryejnë, si dhe përfitimet e ShKK-së nga angazhimi i tyre, Ministria e Drejtësisë dhe ShKK duhet të konsiderojnë që pagesa të rritet. Kjo është kërkesë edhe e vet të dënuarve. Madje, gjatë vizitës, monitoruesit u takuan me të dënuar të cilët e shprehën kërkesën për t'u angazhuar në punë jashtë institucioneve korrektuese (përmes transferimit në QK Smrekonicë), me qëllim të përfitimit më të madh si dhe nevojën për të kontribuar në familjet e tyre.

Në dispozicionin e të dënuarve janë edhe aktivitete tjera, si shëtitja, fushat e sportit, salla e fitnesit, si dhe tavolina e ping-pongut. Të burgosurit janë ankuar për izolim të tepërt gjatë qëndrimit në këtë qendër.

Në BSL janë të vendosur edhe të paraburgosur. Të paraburgosurit u ankuan në izolimin e tepërt dhe mungesën e aktiviteteve të lira. Kjo si rezultat i ndalesave dhe kufizimeve ligjore për këtë kategori, pasi që legjislacioni në fuqi nuk parasheh mundësi për ofrimin e aktiviteteve shtesë apo angazhimit në punë për të paraburgosurit. Ndërsa vlen të theksohet se angazhimet e të dënuarve në aktivitetet të ndryshme të punës janë shtuar në këtë institucion.

Njësia shëndetësore në BSL është e kompletuar me të gjitha pajisjet mjekësore të nevojshme. Ndër pajisjet mjekësore, posedojnë edhe ultrazërin, i cili nuk shfrytëzohet nga mjekët e përgjithshëm pasi që nuk janë të trajnuar për përdorimin e tij. QKRMT ka rekomanduar që mjekët e përgjithshëm të kësaj njësie të trajnohen për përdorimin e ultrazërit sipas protokolleve përkatëse në mënyrë që ky ultrazë të shfrytëzohet në vazhdimësi për nevojat

e pacientëve. Gjatë monitorimit është vërejtur se barnat ruhen në mënyrë të rregullt. Njësia Shëndetësore është duke e zbatuar rekomandimin e QKRMT-së, në atë mënyrë që barnat të cilat janë afër skadimit të afatit të tyre të vendosen në një vend të veçantë.

Duhet theksuar, që BSL është i vetmi institucion ku antishok terapia është e vendosur në të gjitha ambientet e njësive shëndetësore në set të veçanta dhe me listën e përmbajtjes të vendosur në setin e antishok terapisë. Po ashtu, në këtë institucion të gjitha protokollet dhe dosjet mjekësore të monitoruara ishin të plotësuara sipas procedurave të Departamentit Shëndetësor të Burgjeve.

Në BSL nuk ka numër të madh të përdoruesve të substancave narkotike. Në vizitën e realizuar në shkurt 2021, 7 të burgosur me varësi nga narkotikët kanë qenë të vendosur në BSL. Në BSL ende nuk ka filluar zbatimi i programit të metadonit për të dënuarit përdorues të substancave narkotike.

3. QENDRA KORREKTUESE NË SMREKONICË

Monitoruesit e QKRMT-së kanë zhvilluar vizitë monitoruese në QK Smrekonicë me 28 tetor 2021.

Deri në vitin 2019, në QK Smrekonicë janë vendosur të dënuarit me dënime të shkurta ose me mbetje dënimi deri në 3 vjet. Nga data 13.08.2019, Ministri i Drejtësisë kishte nxjerrë vendim për lejimin e transferit të të dënuarve në QK në Smrekonicë, përfshirë edhe të dënuar me dënime afatgjata. QK Smrekonicë ka kapacitet prej 200 vendeve, ndërsa gjatë vizitës monitoruese gjendeshin 121 të burgosur dhe 3 të tjerë ishin në vikende. Kjo qendër nuk akomodon të paraburgosur.

QK Smrekonicë, si institucion i tipit të hapur, ofron kushte më të favorshme për të dënuarit. Të dënuarit janë të lirë të dalin dhe lëvizin jashtë dhomave të tyre, të angazhohen në punë dhe aktivitete tjera, të shfrytëzojnë vikendet, etj. Madje, disa prej të dënuarve u është mundësuar të punojnë jashtë institucionit dhe të kthehen në mbrëmje, mirëpo për shkak të pandemisë kjo për momentin është ndaluar.

QKRMT vlerëson se kriteret për vendosjen e të dënuarve në QK Smrekonicë duhet të jenë më specifike dhe t'i mundësojnë shumicës së të dënuarve me sjellje të mira, të përfitojnë nga ky regjim në funksion të qëllimit të dënimit – rehabilitimit dhe riintegrit. QKRMT madje ka sugjeruar se do të ishte shumë pozitive që një regjim i tillë në të ardhmen t'u mundësohet edhe femrave të dënuara.

Edhe në QK Smrekonicë ka një numër të konsiderueshëm të të dënuarve me probleme mendore [rreth 25], të cilët janë me terapi të psikiatrit. Sipas stafit mjekësor, nuk kanë ndonjë problem të theksuar në menaxhimin e tyre.

Kontrabanda mbetet e pranishme në QK Smrekonicë. Gjithashtu, kishte pohime për trajtim jo të barabartë sa i përket fitimit të beneficioneve,

sidomos sa i përket PLK-së. Këto beneficione, sipas të dënuarve, në shumë raste fitohen përmes korrupsionit.

Sikurse qendrat tjera, edhe QK Smrekonicë përballet me mungesë të stafit korrektues. Të dënuarit paraqitën ankesa se herë pas here po provokohen nga stafi korrektues.

Ankesat më të mëdha të të burgosurve në QK Smrekonicë ndërlidhen me punën e PLK-së, kualitetin e ushqimit, kushtet materiale të vendosjes, si dhe faktin se nuk lejohen pakot ushqimore dhe zvogëlimi i ditëve të vikendit.

Një pjesë e madhe e të dënuarve të intervistuar u ankuan në efikasitetin dhe në punën e Panelit për Lirim me Kusht, ankesa ndaj shqyrtimit që ju bëhet kërkesave të tyre, përgjigjet e vonuara të PLK-së, etj. Një pjesë e të burgosurve ankoheshin për diskriminim nga Paneli për Lirim me Kusht dhe për mos përfillje të rregullave ligjore rreth lirit me kusht.

Me gjithë sjelljet e tyre të mira dhe raportet pozitive të vlerësimit nga punëtorët social të QK Smrekonicë, PLK-ja ju refuzon kërkesat e të dënuarve mbi bazën e arsyetimeve të përsëritura. Kishte raste kur të dënuarit ishin angazhuar në punë jashtë institucionit, për më shumë se 5 muaj, kurse PLK-ja i kishte refuzuar kërkesën me arsyetimin se paraqet rrezik për sigurinë publike. Fakti se këta të dënuar kanë qenë jashtë institucionit, në punë tek kompanitë private dhe pa përcjellje/mbikëqyrje të stafit korrektues dhe se të njëjtit nuk kanë demonstruar ndonjë sjellje të rrezikshme ose rrezik për sigurinë publike, do të duhej t'i mjaftonte PLK-së të bënte një vlerësim më të saktë të implikimeve për sigurinë publike.

Sa i përket kushteve materiale për vendosjen e të burgosurve, QK Smrekonicë nuk është në nivel të kënaqshëm. Disa nga dhomat i kanë nga gjashtë shtretër. Vendosja e gjashtë personave në këto dhoma, nuk është në përputhje me hapësirën e nevojshme për vendosjen e të dënuarve. Meqenëse ka hapësirë, QKRMT rekomandon që të bëhet një ndarje/vendosje

më proporcionale e të dënuarve, ashtu që tu sigurohet hapësirë e mjaftueshme.

QK Smrekonicë ka një kohë të gjatë që nuk ka pas ndonjë renovim. Muret nëpër disa nga dhomat e vizituara, sidomos në Krahun A, janë mjaft të dëmtuara dhe me myk. Gjithashtu banjat e përbashkëta janë të dëmtuara dhe kanë nevojë për renovime, sidomos intervenim më i shpejt nevojitet tek tavani i banjave, pasi që panelet e tavanit janë demoluar tërësisht pas bastisjeve që janë kryer dhe si rezultat kabllot e rrymës elektrike janë zbuluar dhe paraqesin rrezik potencial për të burgosurit.

Gjatë vitit të fundit, në një pjesë të institucioneve korrektuese janë shpërndarë dyshek e batanije, mirëpo QK Smrekonicë është furnizuar vetëm me batanije, por jo edhe dyshekë. Dyshekët që gjenden nëpër dhomat e të dënuarve ose janë shumë të vjetër ose janë dyshekë që të dënuarit i kanë marrë nga jashtë.

Për shkak të renovimeve në kuzhinën kryesore, një ambient tjetër ishte improvizuar dhe përdorej si kuzhinë. Ambienti i cili përdorej për përgatitjen dhe shërbimin e ushqimit është në gjendje jo të mirë materiale dhe higjienike.

Një numër i të dënuarve paraqitën ankesa ndaj kualitetit si dhe sasisë së ushqimit që u shërbehet. Sipas Drejtorit të QK Smrekonicë, kuzhina e rinovuar shumë shpejt pritet të lëshohet në përdorim. Rinovimet kanë zgjatur më shumë se dy vjet. Kjo për shkak se punimet janë kryer nga vet të dënuarit, e të cilët sipas stafit, kanë hezituat të punojnë më shpejt. Kuzhina e rinovuar u vizitua nga monitoruesit e QKRMT-së. Ky ambient tashmë ofron kushte shumë më të mira për përgatitjen dhe shërbimin e ushqimit.

QK në Smrekonicë, si institucion korrektues i tipit të hapur, do të duhej të parashihte më shumë aktivitete për të dënuarit, sidomos mundësi për angazhim në punë. Aktualisht nuk ka mjaftueshëm mundësi për punë. Varësisht edhe nga sezona ndryshon numri i të punësuarve. Njësia

Ekonomike duhet t'i rritë kapacitetet e veta, duke filluar nga angazhimi i zyrtarëve përgjegjës për trajnime dhe punëtori. Për shkak të pensionimit të zyrtarëve, ende nuk ka mjaftueshëm zyrtarë për të menaxhuar dhe koordinuar aktivitetet e punëtorive.

Gjatë vizitës, një pjesë e të dënuarve ishin të angazhuar në punë [pastrim, kuzhinë, mirëmbajtjen të objektit, etj]. Të dënuarit janë angazhuar edhe në rinovimet e vazhdueshme që bëhen në këtë qendër, siç është rasti me rinovimin e kuzhinës.

QK në Smrekonicë gjatë sezonës së verës ka pasur suksese në prodhimin e produkteve bujqësore si patate, speca, domate, lakër etj. Edhe institucionet e tjera korrektuese janë furnizuar me këto produkte nga QK Smrekonicë, kryesisht me patate.

Për një periudhë të caktuar kohore, para fillimit të pandemisë, një numër i të dënuarve kanë qenë të angazhuar me punë jashtë QK Smrekonicë. Ata kanë dalë nga institucioni në mëngjes dhe janë kthyer në mbrëmje. Kjo praktikë është shumë e nevojshme të rifillojë sërish. Të dënuarit u shprehën të gatshëm të jenë pjesë e këtij programi.

Të dënuarit kanë edhe aktivitete sportive. Ju lejohet përdorimi i telefonit pa kufizime dhe nga dy vizita familjare në javë. I gëzojnë edhe vikendet. Gjatë masave kufizuese anti-Covid, të dënuarit kanë kontaktuar edhe përmes Skype. Komunikimi me anë të Skype kishte filluar të praktikohej në QK Smrekonicë edhe para Pandemisë.

Gjatë monitorimit në QK Smrekonicë, monitoruesit kanë vizituar edhe ambientet shëndetësore. NjShB në QK Smrekonicë, kishte të angazhuar 6 anëtar të stafit në baza të rregullta, kurse në vizita një herë në javë vijnë stomatologu, psikologu e psikiatri.

Sa i përket masave kundër Covid 19, QK Smrekonicë kanë pasur mjaftueshëm furnizime.

Monitoruesit e QKRMT-së e vizituan edhe barnatoren e Njesisë Shëndetësore. Barnatorja ishte e furnizuar mirë, por monitoruesit e QKRMT-së vërejtën se është një numër i barnave me afat të skaduar. Në një hapësirë, brenda barnatores, bashkë me barnat tjera, ishin të vendosura barnat afati i të cilave është afër skadimit si dhe i atyre që u ka skaduar tashmë. Aty gjendeshin 17 pako/tableta me Phenoborbutalum, afati i të cilave kishte skaduar në gusht 2021 si dhe një pako/tableta e Bisolvon me afat të skaduar në shtator 2021. Gjithashtu në dollapin ku mbaheshin pakot me shiringa, njëra nga pakot është gjetur se është me afat të skaduar. Sipas drejtuesit të kësaj Njësie, këto barna gjenden në barnatore për një kohë të pacaktuar, por janë të shënuara si të skaduara dhe janë jashtë përdorimit. Këto barna, me gjithë faktin se u është shënuar skadenca, ato gjenden në të njëjtin ambient me barna me afat të rregullt të përdorimit.

QKRMT rekomandon që barna me afat të skaduar të largohen nga ambienti i farmacisë, në mënyrë që të parandalohet rreziku i përdorimit dhe pasojat eventuale.

4. QENDRA KORREKTUESE PËR FEMRA NË LIPJAN

Ekipi monitorues ka vizituar Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan (QKFL) në datat 15.10.2021 dhe 28.10.2021.

QKFL akomodon të paraburgosura dhe të dënuara me dënime të ndryshme duke përfshirë edhe të miturat e paraburgosura, të dënuara dhe ato me masa edukative. Gjatë vizitës monitoruese [15.10.2021] në QKFL ishin 23 të dënuara dhe 13 të paraburgosura, në mesin e të cilave edhe dy të mitura me çrregullime mendore. Në këtë qendër korrektuese nuk ka hapësira të veçanta për të miturat e dënuara, të paraburgosura si dhe ato me masa edukative, pra vendosja e tyre bëhet në pavijone me të dënuarat dhe të paraburgosurat e moshës madhore.

Një ndër çështjet më shqetësuese të evidentuara nga ekipi monitorues por gjithashtu problem i ngritur nga vetë stafi korrektues është trajtimi i të burgosurave me çrregullime mendore. Personat me çrregullime mendore, për shkak të pamundësisë për t'u mbajtur në institucione të veçanta me përkujdesje psikiatrike të rregullt, akomodohen në QKFL bashkë me të paraburgosurat/dënuarat e tjera, përderisa IPFK nuk ka shtretër të mjaftueshëm. Njëkohësisht, IPFK nuk ka hapësira të veçanta për vendosjen e femrave dhe të miturave. Kurse psikiatria e fëmijëve në QKUK bën vetëm trajtim ambulator dhe rastet e të miturave të paraburgosura/dënuara me masën trajtim psikiatrik i detyrueshëm nuk mund të trajtohen aty.

Një shqetësim tjetër i vazhdueshëm, i evidentuar nga ekipi monitorues por edhe i ngritur edhe nga vetë stafi korrektues është fakti që në mungesë të një qendre paraburgimi/korrektuese për të miturat femra, ato vendosen në QKFL me të paraburgosurat/dënuarat e rritura.

Nga monitorimi i realizuar, QKRMT nuk ka pranuar ankesa apo pohime nga të paraburgosurat/dënuarat për keqtrajtim në këtë qendër. Pjesa më e madhe e të intervistuarve kanë deklaruar se kanë raporte të mira me stafin

korrektues, por kishte nga to që kanë adresuar shqetësime për qasjen e disa nga oficerët korrektuese ndaj tyre.

Ekipi monitorues ka vërtetuar që në momentin e vizitës në QKFL janë të vendosura dy të paraburgosura të mitura me çrregullime të shëndetit mendor. *QKFL nuk ofron kushte adekuate për trajtimin e kësaj kategorie, as nga aspekti i burimeve njerëzore profesionale sa i përket stafit shëndetësor dhe korrektues, por as nga kushtet materiale ekzistuese.*

Sa i përket trajtimit të përgjithshëm në mesin e të paraburgosurave kishte pakënaqësi me procedurën e bastisjeve nëpër dhoma. Sipas ankesave, bastisja rregullisht bëhet pa praninë e tyre. Ankesa të vazhdueshme kishte për PLK-në, ku numri i atyre që përfitojnë nga kjo e drejtë është mjaftë i ulët.

Sa i përket infrastrukturës në QKFL, nuk ka pasur përmirësime të kushteve. QKFL është një ndër institucionet korrektuese e vendosur në objekte të vjetra. Stafi korrektues, stafi shëndetësor dhe vetë të burgosurat janë të pakënaqura me ambientin fizik të ndërtesës. Dhomat ku të burgosurat janë të vendosura kanë minimumin e nevojshëm për ndriçim. Mungesa e ndriçimit është evidentuar edhe në ambientet/zyrat ku punojnë zyrtarët korrektues dhe stafi shëndetësor. Ambulanta si dhe dhoma ku mbahen seancat psikologjike, përveç mungesës së ndriçimit dhe ajrosjes, gjithashtu janë të shtrira në mes të pavijonit ku janë të vendosura të dënuarat, dhe për këtë arsye nuk i plotësojnë kushtet për trajtim. Pastërtia në përgjithësi ishte në nivel të mirë dhe mirëmbahet nga të burgosurat.

Ekipi monitorues ka vërejtur që banjat ku pastrohen të burgosurat ishin në gjendje të pakënaqshme: në hyrje të banjave kishte rrjedhje të shiut nga tavani, si dhe kishte pikje të vazhdueshme nga nyjat sanitare; në disa nga kabinat e dushit mungonin mekanizmi i hapjes dhe i mbylljes së ujit, si dhe përshtatja e ngrohtësisë së ujit bëhej nga bateritë e vendosura në korridor dhe jo brenda kabinës së dushit. Pikje të ujit nga reshjet e shiut kishte edhe në korridoret e pavijonit C në katin e dytë [evidente gjatë vizitës monitoruese].

Në mesin e të paraburgosurave/dënuarave kishte gjithashtu ankesa për mungesë të ujit të pijshëm, të cilin ato duhet ta sigurojnë vetë. Gjithashtu, ka mungesë të pajisjeve televizive nëpër dhoma. Të burgosurat duhet vetë të sigurojnë pajisjet televizive, por shumë nga ato vijnë nga familje me kushte të vështira ekonomike dhe nuk kanë mundësi t'i sigurojnë nga familja.

QKRMT gjatë vizitës monitoruese ka evidentuar që ngrohja në ambientet e QKFL-së ende nuk ishte plotësisht funksionale dhe që temperatura në dhomat e të burgosurave dhe zyrat e stafit korrektues dhe shëndetësor ishte shumë e ulët. Në disa dhoma gjithashtu është observuar që dritaret e dhomave nuk janë funksionale ngaqë nuk mund të mbyllen tërësisht.

Ekipi monitorues i QKRMT-së gjithashtu ka evidentuar nga deklaratat e zyrtares sociale, stafit korrektues si dhe zëvendëses së drejtorit që mungon objekti i veçantë për qëndrim të nënave me fëmijë, ashtu siç është e përcaktuar me ligj. Derisa QKF ka qenë e vendosur në objektin tjetër [ku tani janë të miturit], ka ekzistuar objekti i veçantë për nënat me fëmijë.

QKRMT e ka ngritur shumë herë çështjen e rregullimit të objektit që është paraparë për nëna dhe fëmijë, por deri më tani nuk janë marrë masa nga autoritetet relevante.

QKRMT vlerëson se objekti ku janë të vendosura të paraburgosurat dhe të dënuarat nuk i plotëson kushtet adekuate të infrastrukturës. Objekti, si i tillë është mjaftë izolues, sidomos për të dënuarat me dënime të gjata, andaj rekomandojmë që të vlerësohet kjo gjendje dhe në planet afatmesme të parashihet ndërtimi i një objekti të ri për vendosjen e femrave të dënuara, duke përfshi mundësinë e organizimit dhe realizimit të aktiviteteve përkatëse.

Të paraburgosurat u ankuan për mungesën e aktiviteteve të ndryshme. Gjatë 24 orëve kanë dy herë shëtitje nga një orë, por për shkak të motit të

ftohtë dhe me shi këto shëtitje nuk realizohen nga të gjitha. Të dënuarat të cilat dëshirojnë të punojnë janë të angazhuara me punë brenda QKFL-së, në kuzhinë apo pastrim. Gjatë verës të dënuarat kanë punuar në sera. Aktivitetet e tjera janë shumë të mangëta. Përveç dhomës së rrobaqepësisë e cila frekuentohet nga disa të dënuara, në QKFL nuk organizohen aktivitete të tjera. Në kuadër të aktivitetit të rrobaqepësisë, të dënuarat të cilat frekuentojnë rrobaqepësinë kanë qepur një numër të madh të maskave, çanta si dhe çarçafë dhe mbulesa për jorganë dhe jastëk.

Në mesin e të dënuarave ekziston një interesim i madh për trajnime profesionale, sidomos në fushën e floktarisë por mungojnë instruktorët. Aktualisht realizohet vetëm trajnimi për furrtari për ato që janë të interesuara. Në këtë qendër nuk ka ndonjë sallë për realizimin e aktiviteteve sportive.

Infrastruktura e kësaj qendre pamundëson organizimin dhe realizimin e aktiviteteve të ndryshme, përderisa ka kërkesa të vazhdueshme nga të dënuarat që të kenë mundësi të realizimit të këtyre aktiviteteve.

Sipas të dënuarave të intervistuar, ka shumë të dënuara që nuk kanë të kryer shkollimin fillor, andaj është e nevojshme që të organizohet mësim bazik për to.

Kushtet fizike në QKFL nuk janë të përshtatshme për funksionimin adekuat të njësisë shëndetësore, pasi që mungojnë ambientet e veçanta të ndara nga pavijoni i të dënuarave. Stafi shëndetësor gjithashtu paraqiti shqetësimet lidhur me sigurinë e tyre, sepse të dënuarat kanë qasje të rregullt në dhomat e njësisë së shëndetësisë dhe duke pasur parasysh natyrën e dënimeve të gjata të të dënuarave si dhe shqetësimet e mundshme që mund të kenë me shëndetin mendor, vendndodhja e njësisë shëndetësore në kuadër të pavijoneve konsiderohet shqetësuese.

Njësia shëndetësore brenda QKFL as për së afërmi nuk i plotëson kushtet e pranueshme për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për të paraburgosurat dhe të dënuarat. Prandaj, QKRMT *rekomandon që të bëhet një zgjidhje e pranueshme për ri-vendosjen e ambulancës mjekësore brenda QKFL-së.* Po ashtu, ekipi monitorues kishte pranuar disa ankesa nga të dënuarat për vonesa në trajtim mjekësor, të cilat u adresuan te stafi shëndetësor.

5. QENDRA KORREKTUESE PËR TË MITUR NË LIPJAN

Ekipi monitorues ka vizituar Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan në datat 11.06.2021 dhe 18.11.2021.

QK për të Mitur në Lipjan është e vetmja qendër korrektuese në Kosovë e cila akomodon të miturit që kanë rënë ndesh me ligjin. Në këtë qendër akomodohej të mitur të dënuar; të mitur me masa edukuese korrektuese, të mitur në paraburgim, si dhe ka funksionuar një pavijon i veçantë për të dënuar madhorë. Gjatë vizitës monitoruese [18.11.2022] numri i të vendosurve në këtë qendër ishte 53, nga të cilët: 24 të mitur me masë edukative, 8 të mitur të dënuar me burgim për të mitur, 10 të mitur të paraburgosur, si dhe 11 të dënuar madhorë.

Ekipi monitorues ka evidentuar faktin që të dënuarit madhor të cilët angazhohen me punë në këtë qendër vazhdojnë të jenë të vendosur në Pavijonin I, i cili edhe pse ndaras nga pavijonet e tjera, është i vendosur në objektin ku mbahet mësimi për të miturit dhe në këtë mënyrë të miturit disa herë në ditë mund të jenë në kontakt me të dënuarit e rritur. Në të njëjtin objekt janë të vendosur edhe ambulanta dhe kuzhina. Gjithashtu, disa prej të dënuarve madhorë punonin në kuzhinë dhe sipas deklaratave të disa të miturve, në kohën e ushqimit ndodhë që të miturve t’ju shërbehet ushqimi nga të dënuarit madhorë. Të dënuarit madhor të vendosur në Pavijonin I në QKM, ishin të dënuar për këto vepra penale: vrasje , grabitje, një rast për dhunë në familje dhe një rast për keqpërdorim seksual të personave nën 16 vjeç, i cili ishte i dënuar me 7 vjet burgim. Në mesin e tyre kishte të dënuar me 25 vjet burgim.

Gjatë monitorimit, QKRMT ka vizituar ambientet e banimit të të dënuarve dhe i ka intervistuar disa prej tyre, qoftë individualisht apo në grup. Të miturit e intervistuar deklaruan se herë pas here ka konflikte mes tyre, ndërsa në dy raste pohuan për përdorim të forcës ndaj tyre. Në rastin e parë deklaruan se pas një konflikti mes të miturve, gjatë intervenimit të stafit [njësia intervenuese], është përdorur forcë fizike për t’i ndarë, ku sipas tyre

të gjithë janë “goditur me shuplaka” pavarësisht përfshirjes në konflikt. Ndërsa në një rast tjetër një i mitur ka deklaruar se është rrahur pas arrestimit. Sipas evidencave të QKM gjatë vitit 2021 [deri më dt. 18.11.2021] janë përpiluar 27 raporte diciplinore, ndërsa nuk ka të evidentuar raste të përdorimit të forcës fizike [përfshirë edhe forcën proporcionale]. Megjithatë vërehet që në këto evidenca nuk përfshihen të gjitha incidentet, rast konkret ishte një incident i ndodhur brenda shkollës në QKM, të cilin QKRMT e ka evidentuar në bazë të dosjes mjekësore të një të mituri, i cili ishte lënduar gjatë përleshjes.

QKRMT rekomandon që çfarëdo lloji i incidentit apo i përdorimit të forcës duhet të përfshihet në evidencat e QKM-së. Po ashtu, QKRMT mbetet e shqetësuar me pohimet për përdorimin e forcës ndaj të miturve.

Gjatë bisedave monitoruese me të miturit e dënuar, paraburgosur dhe atyre me masë edukative nga ekipi monitorues në QK për të mitur janë evidentuar tre të mitur analfabetë të cilët nuk mund të përfitojnë nga e drejta për vazhdimin/fillimin e shkollimit gjatë qëndrimit në QK për të mitur. Kjo për shkakun se Ministria e Arsimit nuk ofron programe të tjera shtesë/programe speciale [përveç programeve të zakonshme mësimore për mësim fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë] për t’i përshtatur nevojave të të miturve. Raste të tilla kryesisht i përkasin komuniteteve jo-shumicë [rom, ashkali, etj.].

QKRMT rekomandon që në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, të organizohet mësim special për të miturit që nuk mund të vazhdojnë shkollimin në mungesë të klasave përkatëse për nivelin e tyre arsimor. Ky bashkëpunim duhet të ketë për bazë trajtimin e barabartë për të gjithë të miturit në QK për të Mitur dhe me ofrimin e mundësisë për të mësuar shkrim dhe lexim, të miturit analfabetë do të mund të kenë mundësi të barabarta me të miturit tjerë të akomoduar në këtë qendër, sidomos për të miturit me masë edukative, ku vet shqiptimi i kësaj mase e ka këtë qëllim.

Gjatë vitit 2021 në QKM Lipjan janë bërë disa renovime në pavijonet e banimit dhe kushtet janë përmirësuar dukshëm për dallim nga gjendja e mëparshme. Pavijoni B ishte i pabanuar për shkak të nevojës për renovim.

Në pavijonin A edhe pse ishin bërë renovimet, tavanet e banjave menjëherë ishin mykur nga lagështia për shkak të mungesës së ajrosjes. Të miturit u ankuan për mungesë të ujit të ngrohtë për pastrim, sipas tyre uji i ngrohtë harxhohet shumë shpejt dhe nuk arrin të ngrohet brenda orarit të caktuar dhe shpesh ata duhet të bëjnë dush me ujë të ftohtë. Ngrohësja ishte funksionale por ishte në temperaturë minimale dhe të miturit treguan që gjatë natës ngrohëset ndalen tërësisht. Edhe pse objekti i rinovuar, shumë nga dritaret në dhomat e të miturve nuk ishin funksionale sepse depërtonte të ftohtit nga jashtë.

Në këtë qendër ushqimi nuk përgatitet aty por bartet nga QK e Femrave, me termose të mbyllur për ushqim. Të dënuarit dhe stafi patën ankese për darkën, sipas tyre ajo është jo cilësore. Kryekuzhinieri nuk ishte i pajisur me librezë sanitare si dhe pa staf mbështetës, por ndihmohej nga një depoist apo lavanterier. Kuzhina kryesisht ishte e pastër, mirëpo makina për larjen e enëve nuk punonte.

Të miturit realizojnë vizita të rregullta familjare dhe u mundësohen bisedat telefonike sipas rendit shtëpiak. Në pamundësi të vizitave familjare u mundësohet kontakti me familjarët përmes Skype. Të miturit e dënuar dhe ata me masë edukative kanë TV nëpër dhomat e tyre. Pajisjet televizive duhet të sigurohen nga vetë familjarët e të miturve. Programet që ofrohen janë vetëm ato të rrjetit tokësor.

Ambulanca ishte e kompletuar me staf të mjaftueshëm, gjithashtu furnizimi me barna ishte i mjaftueshëm.

6. QENDRA EDUKATIVE KORREKTUESE NË LIPJAN

Ekipi monitorues ka vizituar Qendrën Edukative Korrektuese në Lipjan (QEK) në datën 18.11.2021. Kapaciteti i kësaj qendre ishte 36 shtretër, ndërsa ishin të vendosur vetëm 8 të mitur me masë edukative. Të miturit e tjerë me masë edukative (24 të mitur) ishin vendosur në QK për të Mitur

QEK për miturit është institucion i veçantë për ekzekutimin e Masës Edukative, është i tipit të hapur dhe i cili funksionon nën menaxhimin e QKM Lipjan. Pranimi i të miturve bëhet sipas akteve të brendshme të institucionit, ku në bazë të kriterëve të përcaktuara, paneli multidisiplinar jep rekomandim tek drejtori se cilët të mitur të vendosen në QEK. Po ashtu edhe kthimi i tyre nga QEK në QK për të Mitur bëhet sipas kushteve apo kriterëve të vendosura nga ShKK, duke vlerësuar nivelin e shkeljeve të bëra nga i mituri (disa nga rastet e shkeljeve të rënda konsiderohen tentimi për arratisje si dhe futja e lëndëve narkotike në qendër). Vlen të theksohet se në këtë institucion nuk ka pasur të vendosura të mitura femra. Ekziston një pavijon i veçantë i paraparë për vendosjen e të miturave, por sipas mbikëqyrësit të QEK nëse do të vendoseshin të mitura femra në këtë institucion, menaxhimi i tyre do të ishte mjaft i vështirë për shkak të strukturës së objektit, ku problemi kryesor do të ishte mbajtja larg nga të miturit meshkuj.

Gjatë monitorimit, QKRMT ka vizituar ambientet e banimit të të miturve dhe i ka intervistuar disa prej tyre, qoftë individualisht apo edhe në grup. Të miturit e intervistuar në përgjithësi janë shprehur të kënaqur rreth trajtimit të tyre nga ana e stafit të QEK për të Mitur. Të miturit shprehën pakënaqësi lidhur me pamundësinë për punësim për të miturit mbi moshën 18 vjeçare, duke pasur parasysh tipin e hapur të qendrës. Ankesa tjera nga të miturit ka pasur lidhur me hapësirat e shumta që detyrohen të pastrojnë si dhe për mos pagesën e ditëve të fundjavës edhe përkundër faktit që punojnë gjatë këtyre ditëve.

QEK për të Mitur sa i përket kushteve materiale qëndron mjaft mirë, duke marr parasysh se objekti i kësaj qendre është relativisht i ri, megjithatë gjatë

TË DREJTAT E NJERIUT NË INSTITUCIONET KORREKTUESE NË KOSOVË

monitorimit ekipi i QKRMT në dhomat e vizituara ka vërejtur se dorëzat e banjave janë jashtë funksionit si dhe në tavanet e banjave kishte pjesë të dëmtuara të pllakave. Të miturit ishin të akomoduar nëpër dhoma nga dy persona ndërsa kishte dhoma edhe me nga një të mitur.

Të miturit janë ankuar në mungesë të produkteve higjienike për pastrim. Sipas tyre furnizimet që u jepen për pastrim të dyshemesë janë të pamjaftueshme dhe shpeshherë duhet të bëjnë zgjidhje alternative për pastrimin e dhomave dhe korridorit.

Të miturit gjithashtu u ankuan me kualitetin e ushqimit, sidomos të bukës.

Gjatë vizitës, ekipi monitorues i QKRMT ka vërejtur se në një pjesë të konsiderueshme të objektit të QEK nuk kishte ngrohje, sidomos tek pjesa e objektit ku mbahen aktivitetet për trajnime të ndryshme dhe rekreacion.

QKRMT rekomandoi që urgjentisht të bëhet zgjidhje për ngrohje në të gjitha ambientet e QEK.

Të miturit realizojnë vizita të rregullta familjare dhe u mundësohen bisedat telefonike sipas rendit shtëpiak. Të miturit kanë TV nëpër dhomat e tyre, pajisje të cilat ata duhet t'i sigurojnë vetë. Programet që ofrohen janë kryesisht ato nacionale. Në këtë qendër të miturit e kanë në dispozicion edhe sallën sportive për aktivitete të ndryshme sportive si dhe dhomën për aktivitete shoqërore, muzikë, kulturë, art etj.

Shkollimi për të miturit është i organizuar në Qendrën Korrektuese për të Mitur, pra të miturit e kësaj qendre mësojnë në klasa të përbashkëta me ata nga QK. Programi dhe struktura mësimore ishte sikurse në të kaluarën, brenda një klase mësojnë të miturit e klasave të ndryshme. Po ashtu, sipas të miturve përkundër drejtimeve të ndryshme lëndët mësimore janë të njëjta për të gjithë, pra mungojnë lëndë profesionale, andaj disa të mitur ankohen ngase mësimet e ofruara nuk përputhen me orientimin e tyre shkollor për të ardhmen. Ankesa nga të miturit në këtë aspekt ka pasur edhe

sa i përket cilësisë së orëve mësimore, të cilat sipas tyre janë të nivelit të dobët.

Njëri nga të miturit në QEK është duke kryer fakultetin jashtë institucionit, dhe i është mundësuar ndjekja e ligjëratave online, po ashtu edhe kryerja e provimeve.

Shqetësuese mbetet përfshirja në procesin mësimor të të miturve të cilët nuk kanë shkollim paraprak, pra disa prej të cilëve nuk din shkrim-lexim dhe nuk mund të përfshihen në procesin mësimor me të miturit e tjerë, pasi që niveli i tyre i arsimimit është i ulët e po ashtu ka të tillë që nuk kanë të kryer asnjë klasë të shkollës fillore.

QKRMT rekomandon që në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, të organizohet mësim special për të miturit që nuk mund të vazhdojnë shkollimin në mungesë të klasave përkatëse për nivelin e tyre arsimor.

QEK për të Mitur në bashkëpunim me organizata të ndryshme ka arritur që të angazhojë të miturit në aktivitete të ndryshme. Njëra nga aktivitetet më të suksesshme ishte punimi i kokërrshilteve, me çka të miturit kanë kontribuar tek disa institucione publike. Po ashtu, të miturit janë angazhuar në aktivitete të punës me shtyp/printim ku posedonin pajisje me aparaturë për shtyp në produkte të ndryshme si bluza, gota, enë si dhe shtypje të vizitkartave etj., megjithëse, momentalisht mungojnë projekte që do t'u mundësonin angazhim më aktiv me këtë punë. Këto aktivitete dhe programe janë realizuar përmes projekteve siç janë: programi i Komitetit të Helsinkut Holandez i cili në partneritet me QKRMT angazhohet në përmirësimin e kushteve për riintegrimin e të paraburgosurve të mitur dhe bazohet në idenë se themelet e një riintegrim të suksesshëm vendosen brenda vendeve të paraburgimit. Gjithashtu, riintegrimi i të miturve në QEK mbështetet edhe nga programet e UNICEF, HELP, CARITAS Kosova etj.

TË DREJTAT E NJERIUT NË INSTITUCIONET KORREKTUESE NË KOSOVË

QKRMT e vlerëson realizimin e këtyre aktiviteteve të cilat kanë qenë gjithëpërfshirëse dhe të mirëpritura nga të miturit, andaj rekomandon që këto kapacitete të shfrytëzohen për prodhimin e produkteve të cilat mund të shfrytëzohen për reprezentacion nga Ministria e Drejtësisë dhe institucionet e tjera.

Njësia shëndetësore ishte e kompletuar me staf të mjaftueshëm. Sipas tyre të gjitha pajisjet janë funksionale dhe punët shkonin sipas planit të punës.

Ekipi monitorues ka evidentuar se disa të dhëna në protokolle nuk ishin shënuar plotësisht, p.sh. në protokollin e vetmisë / izolimit, nuk kishte një ndarje ku dallohet viti 2021, ndërsa tek një rast nuk ishte shënuar fare data e vizitës në protokollin e izolimit. Pra rasti është evidentuar që është vizituar, mirëpo në bazë të protokollit nuk dihet periudha apo data e vizitës. Po ashtu në protokollin e grevës së urisë, ishte një rast që mungonte data e evidentimit, sipas përgjegjësit, ky është rast i mëhershëm.

Tek një rast i incidentit që ka rezultuar me lëndime të lehta trupore ekipi monitorues gjeti se figuronte në dosjen e të miturit ndërsa nuk ishte evidentuar në protokollin e lëndimeve trupore. Sipas infermierit përgjegjës, rasti nuk është evidentuar në protokollin e lëndimeve pasi që ishte lëndim i lehtë. Lidhur me këtë incident ekipi monitorues gjithashtu ka vërejtur nga dosja e të miturit se incidenti ka ndodhur në kohën kur i njëjti ka qenë i evidentuar se ishte i vendosur në karantinim sipas regjistrimit të karantinimit, ndërsa sipas përshkrimit, incidenti kishte ndodhur në klasë gjatë mbajtjes së orëve të mësimi. Pra, sipas evidencave rasti ka qenë në karantinë, dhe ashtu është evidentuar, ndërsa në datë të njëjtë është lënduar në një incident në shkollë.

QKRMT rekomandon që çdo rast i lëndimeve duhet të protokollohet sipas procedurave standardeve, pavarësisht llojit të lëndimit. Për më tepër, vlerësimi i infermierëve se cilat raste të evidentohen në protokoll në bazë të vlerësimeve të tyre rreth llojeve të lëndimeve, është në kundërshtim me

praktikën e ndërtuar nga Departamenti Shëndetësor i burgjeve për evidentimin e rasteve të tilla.

7. QENDRA E PARABURGIMIT NË PRISHTINË

Ekipi monitorues ka vizituar Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë në datat 24.02.2021 dhe 15.12.2021.

QP në Prishtinë, kryesisht akomodon të paraburgosur dhe të dënuar të cilët kanë më pak se dy vjet deri në përfundimin e vuajtjes së dënimit. Megjithatë, gjatë vizitave u evidentuan edhe të dënuar me dënime më të gjata.

Qendra e Paraburgimit në Prishtinë është institucion korrektues i tipit të mbyllur. Kapaciteti i kësaj qendre është për 323 të burgosur. Gjatë vizitës monitoruese më 15 dhjetor 2021 ishin të vendosur 254 të burgosur, nga të cilët 208 të paraburgosur dhe 46 të dënuar. Po ashtu 6 të burgosur gjendeshin në IPFK për ekzaminim psikiatrik, ndërsa një i burgosur në QKUK. Në QP Prishtinë ndodhet edhe Qendra e Vlerësimit dhe Klasifikimit për të dënuarit / pranuarit e ri si dhe pranimi i personave të cilët shkojnë vullnetarisht për ta vuajtur dënimin. Për këto arsye edhe ka shumë lëvizje të të burgosurve nga QP në Prishtinë, qoftë për shkak të pranimeve të reja, transporteve nëpër gjykata dhe spitale, transfereve, etj. Kjo qendër përballet me mungesa të stafit korrektues, por stafit pritet t'i shtohen 10 oficerë korrektues.

QP në Prishtinë vazhdon të sfidohet nga të burgosurit me probleme mendore. Në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës ka numër të vogël shtretërisht, andaj një numër i të burgosurve me probleme mendore shpesh duhen të akomodohen në QP në Prishtinë. Në ditën e monitorimit [15.12.2021] ishin të pranishëm afërsisht 40 raste me çrregullime mendore, ku për shumë prej tyre kërkohej ekzaminim psikiatrik në IPFK, por në mungesë të hapësirave në IPFK janë vendosur në QP në Prishtinë. Si dukuri mjaft shqetësuese mbetet edhe numri i rasteve të tentim vetëvrasjeve në këtë qendër. Gjatë vitit 2021 Numri i tentim vetëvrasje ka arritur në shtatë, ndërsa ka ndodhur njw vetëvrasje.

Dukuria e kontrabandës mbetet ende prezentë në këtë institucion. Gjatë vitit 2021 janë evidentuar gjithsej 6 raste të parandalimit të kontrabandës dhe dy raste të kontrabandës, ku ka rezultuar edhe me suspendimin e dy anëtarëve të stafit.

Nga takimet me të burgosurit, ka pasur pohime për bastisje të shpeshta dhe të cilat janë realizuar zakonisht gjatë kohës së shëtitjeve. Gjatë bastisjes nuk kanë qenë të pranishëm asnjëri nga të paraburgosurit e dhomës përkatëse.

Ekipi monitorues ka evidentuar një rast të raportuar për përdorim të forcës nga zyrtarët korrektues, i cili është adresuar te menaxhmenti.

Në QP në Prishtinë kishte edhe të paraburgosur shtetas të huaj. Këta shtetas të huaj, kryesisht janë nga vendet arabe, ata kanë vështirësi në komunikim me stafin korrektues dhe atë shëndetësor.

Shqetësimet kryesore të të paraburgosurve ndërlidhen me punën e gjykatave dhe mungesën e aktiviteteve të lira. Në mesin e të paraburgosurve ka edhe nga ata që gjenden në paraburgim për një kohë të gjatë. Vonesat e gjykatave në vendosje, si dhe rigjykimet nga dy e tre herë, po ndikojnë në stërzgjatje të paraburgimit. Përderisa janë me statusin e të paraburgosurit, ata kanë më pak të drejta, privilegje dhe aktivitete gjatë qëndrimit në institucione korrektuese.

QP në Prishtinë që nga funksionalizimi i saj është përballur me sfida të ndryshme në drejtim të kushteve materiale për vendosjen e të burgosurve. Disa pjesë të QP në Prishtinë i janë nënshtruar renovimit, e disa të tjera pritët të fillojnë ndërkohë. Në të ardhmen e afërt pritët të realizohet ndërtimi i një salle sporti si dhe një salle fitnesi.

Ekipi monitorues u njoftua se QP në Prishtinë ka pranuar donacion nga Ambasada Amerikane tel sigurie për rrethimin e qendrës ndërsa punimet janë kryer nga të burgosurit. Gjithashtu, në Bllokun A5 ishte ofruar një

donacion tjetër për montimin e dyerve automatike për të burgosurit, dhe ky pilot projekt ishte në fazën testuese

Ekipi monitorues u njoftua që në Bllokun B, dhomat me nr. 2, nr.4 dhe nr.6 pritet të rregullohen për vëzhgim me kamera, për lehtësimin e vëzhgimit të vazhdueshëm të rasteve nën këtë masë. Në dhomat dyshe, ku janë të vendosur nga dy të burgosur, janë të pajisur me shtretër dy-katësh. Në disa nga dhomat e vizituara, të burgosurit e kishin vendosur dyshekun në dysHEME. Arsyeja kryesore pse një pjesë e të burgosurve nuk e përdorin katin e dytë të shtratit është se këta shtretër nuk kanë shkallë për të hipur në pjesën sipër. Për t'u ngjitur në pjesën e sipërme duhet t'i përdorin grilat e dritareve, për të mbështetur këmbën. Për më tepër, pjesa e sipërme e shtratit nuk kishte anësore mbështetëse.

Gjatë monitorimit në Bllokun B, Krah B1, ekipi i QKRMT ka vërejtur se në banjën e këtij krahu ishte formuar myk në tavan dhe në një pjesë të murit shkaku i lagështisë.

Nga të paraburgosurit kishte ankesa për ujë të ngrohtë të pa mjaftueshëm, pasi që njëri ngrohës i ujit ishte i prishur dhe si pasoj nuk funksiononin me kapacitete të plota. Sipas të paraburgosurve, vetëm dhomat e para mund të pastrohen me ujë të ngrohtë, ndërsa pjesa tjetër e të paraburgosurve mbeten pa të.

Ekipi monitorues QKRMT vërejti se tek kabinat telefonike mungonin fletat informuese me numrat kontaktues të institucioneve ku ata do të mund të telefononin lidhur me ndonjë çështje, p.sh. kontakti i Institucionit të Avokatit të Popullit.

Ndryshim pozitiv sa i përket vizitave familjare është largimi i pengesës fizike në dhomat e vizitave. Ky ka qenë një shqetësim i të paraburgosurve i shprehur disa herë.

Të paraburgosurit u ankuan në izolimin e tepërt dhe mungesën e aktiviteteve të lira. Kjo si rezultat i ndalesave dhe kufizimeve ligjore për këtë

kategori, pasi që legjislacioni në fuqi nuk parasheh mundësi për ofrimin e aktiviteteve shtesë apo angazhimit në punë për të paraburgosurit. Gjatë 24 orëve, 22 orë janë të mbyllur në dhomat e tyre.

Njësia shëndetësore ishte furnizuar me pajisje shtesë siç është aparatura për matjen e pesë parametrave vital, aparatura për radiologji si dhe aparatura për analizat e gjakut/hemogram. Aparatura për radiologji është në funksion edhe pse në mungesë të një radiologu, punën e kryen njëra nga 3 doktorëshat në këtë njësi, e cila është në përfundim të specializimit në këtë fushë. Gjithashtu edhe për punët në laborator kujdeset infermierja e cila është e trajnuar për analiza laboratorike, edhe pse aparatura e hemogramit ende nuk ishte funksionalizuar në mungesë të materialit përcjellës për analiza. Gjatë viti 2021, janë realizuar gjithsej 24 analiza biokimike, mirëpo gjatë vizitës monitoruese është evidentuar mungesa e reagentave për kryerjen e analizave. Analizat e fundit në këtë laborator janë kryer më dt. 15.07.2021.

Sfiduese për njësinë shëndetësore mbetet trajtimi i rasteve me çrregullime mendore, për shkak të numrit të lartë dhe vonesave për ekzaminim në IPFK. Përmirësim i dukshëm në këtë drejtim është bërë me angazhimin e dy psikiatërve konsulentë, ku shërbimet psikiatrike kryhen dy herë në javë.

Gjatë monitorimit është vërejtur se furnizimi me barna ishte i mirë, barnat ruheshin në mënyrë të rregullt. Nga dosjet e shikuara, të zgjedhuara me metodën e randomizimit, të gjitha ishin të plotësuara në mënyrë të duhur. Po ashtu protokollet plotësoheshin me rregull dhe plotësisht sipas procedurave.

Në QP në Prishtinë nga muaji korrik 2020 zbatohet programi i metadonit. Gjatë vizitës monitoruese në këtë program ishin dy persona, të cilët e merrnin terapinë e tyre në mënyrë të rregullt. Sipas përgjegjëses së njësise numri i rasteve që janë përfshirë në programin e metadonit gjatë vitit 2021 arrin mbi 20. Sipas stafit shëndetësor, numri i përdoruesve të substancave narkotike është në rritje, mirëpo ata i kushtojnë kujdes të veçantë, ku në shumë raste bëhet zbulimi i hershëm i këtyre rasteve.

8. QENDRA E PARABURGIMIT NË GJILAN

Ekipi monitorues ka vizituar Qendrën e paraburgimit (QP) në Gjilan me 1 dhjetor 2021. QP Gjilan ka kapacitet prej 300 vendeve, mirëpo vetëm 202 shtretër ishin të shfrytëzueshëm. Gjatë vizitës monitorues ishin 191 të burgosur, nga të cilët 171 të paraburgosur, 20 të dënuar dhe një ishte në IPFK për ekzaminim psikiatrik.

QP në Gjilan i ka gjithsej 128 anëtar të stafit, [112 staf korrektues dhe 16 staf civil]. Është njëra nga institucionet korrektues që ka staf edhe nga komunitetet jo shumicë. Ka nevojë për shtimin e numrit të zyrtarëve korrektues në raport me numrin e të burgosurve.

QP në Gjilan akomodon të paraburgosur por edhe një numër të të dënuarve. Të dënuarit ishin, me dënime të ndryshme, në mesin e tyre kishte edhe me dënime afatgjata. Gjithashtu, ka të burgosur me çrregullime mendore si dhe përdorues të substancave narkotike. Këto kategori paraqesin vështirësi në menaxhim adekuat, meqë as ambienti e as stafi nuk janë në përputhje me nevojat e tyre.

Nga monitorimi i realizuar është observuar se në përgjithësi në QP Gjilan është një atmosferë/klimë e mirë. Të burgosurit nuk paraqitën ndonjë ankesë evidente ndaj stafit. Meqë QP Gjilan mban persona me paraburgime relativisht të gjata, ankesat kryesore të tyre kanë të bëjnë me efikasitetin e punës së gjykatave dhe mungesën e aktiviteteve.

Një ndër çështjet më shqetësuese në QP Gjilan mbeten të burgosurit me çrregullime mendore. Në IPFK ka numër të vogël shtretërish, andaj një numër i të burgosurve me çrregullime mendore shpesh vendosen në këtë qendër. QP Gjilan nuk ofron kushte adekuate për trajtimin e kësaj kategorie, as nga aspekti i burimeve njerëzore profesionale, por as edhe nga kushtet materiale.

Ndër sfidat tjera evidente me të cilat përballet QP Gjilan janë edhe mungesa e ujit të ngrohtë, rruga afër institucionit e paasfaltuar, automjetet për bartjen e të burgosurve janë të dëmtuara, etj.

Ka edhe raste të kontrabandës. Gjatë bastisjeve janë gjetur telefona brenda ambienteve të të burgosurve. Në disa raste tjera është ndaluar kontrabanda, ku janë evidentuar në hyrje të objektit. Vetëm gjatë muajit nëntor janë parandaluar dy raste të kontrabandës.

Nga monitorimi i realizuar, QKRMT nuk ka pranuar ankesa dhe pohime nga të burgosurit për keqtrajtim nga stafi korrektues. Ka raste të izoluar të konflikteve mes të burgosurve, duke përfshirë incidente mes vete si dhe vetëlëndime.

Disa nga të paraburgosurit u ankuan për mungesë të ofrimit të shërbimeve psikiatrike; nuk kontrollohen rregullisht nga psikiatri, ka raste kur vetëm ju përshkruhet terapia e njëjtë pa e vizituar fare.

Përveç vështirësive të institucionit në menaxhimin e të burgosurve me çrregullime mendore, edhe të burgosurit e tjerë paraqitën shqetësimet e tyre. Meqë janë të vendosur në ambiente të njëjta [në dhoma të ndara], të burgosurit tjerë u ankuan se po shqetësohen nga zhurmat dhe sjelljet e të burgosurve me çrregullime mendore. Përveç zhurmës, ka raste edhe të vetëlëndimeve e sulmeve. Gjatë vitit 2021, një zyrtar korrektues është sulmuar nga një i burgosur me çrregullime mendore.

Shqetësimet tjera të të paraburgosurve ndërlidhen me punën e gjykatave si dhe me mungesën e aktiviteteve të lira në QP në Gjilan.

Monitoruesit e QKRMT-së kanë vizituar edhe hapësirën ku janë të vendosura dhomat e vetmisë [4 dhoma të tilla]. Pozita dhe struktura e këtyre dhomave është mjaft e papërshtatshme, pasi që kufizohet qasja në dritë natyrore. Po ashtu shëtitoret e këtyre dhomave janë shumë të ngushta dhe pa qasje në ajër të pastër.

Menaxhmenti i QP Gjilan deklaruan se këto dhoma përdoren shumë rrallë, ndërsa në rastet kur përdoren, shëtitja realizohet në ambientet e shëtitoreve të zakonshme. Mirëpo, gjatë monitorimit, ekipi i QKRMT-së mori informacion se gjatë zbatimit të masës së vetmisë, të burgosurit i shfrytëzojnë shëtitoret afër këtyre dhomave, të cilat gjenden në një korridor mes dy mureve.

QKRMT vlerëson se këto dhoma nuk janë të përshtatshme për zbatimin e masës së vetmisë, e sidomos mungesa e qasjes në ajër të pastër paraqet mangësi serioze.

Sa i përket kushteve materiale në QP Gjilan, shqetësimi kryesor lidhet me mungesën e ujit të ngrohtë. Për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme, një pjesë të madhe të kohës të burgosurit nuk kanë në dispozicion ujë të ngrohtë. Kësisoj, ata përmes disa ngrohësve të ujit, me rrymë, e ngrohin ujin brenda dhomave të tyre për të bërë dush. Kjo përveç që nuk garanton që higjiena të jetë në nivelin e duhur, paraqet edhe rrezik për shëndetin e të burgosurve, pasi që nuk është e sigurt. Konsiderojmë se kjo praktikë nuk është në përputhje me trajtimin e dinjitetshëm të personave të privuar nga liria.

QKRMT rithekson rekomandimin që Ministria e Drejtësisë dhe ShKK të ndërmarrin veprimet konkrete urgjentisht për ofrimin e ujit të ngrohtë për të gjithë të burgosurit në QP Gjilan.

Të burgosurit janë të vendosur nëpër dhoma njëshe dhe dyshe. Kanë dyshekë dhe mbuloja të mira. Edhe pse QP Gjilan është në mesin e institucioneve korrektuese të reja, është e nevojshme rinovimi i disa prej ambienteve. Dyshemeja në korridore dhe muret e disa dhomave janë shumë të dëmtuara dhe duhet rinovuar. *Për shkak të rrjedhjes së ujit, 10 dhoma ishin jashtë funksionit.* Janë dëmtuar bateritë/çezmat dhe deri në rregullimin e tyre këto dhoma nuk mund të përdoren.

Gjithashtu, është evidentuar edhe lagështi në dhomat e të burgosurve. Sipas informacioneve nga menaxhmenti i institucionit, pritjet të gëlqerosen muret e ambienteve të të burgosurve.

Gjatë vizitës monitoruese [1 dhjetor 2021], QP Gjilan ka qenë në proces të disa punimeve/rinovimeve, ku porta kryesore ishte duke u zgjeruar. Gjithashtu, është duke u ndërtuar një objekt i ri afër portës kryesore për pritje dhe kontrollimin e vizitorëve. Këto punime janë duke u kryer në kuadër të donacioneve nga Ambasada Amerikane. Gjithashtu, shëtitoret janë në proces të ndarjes, ku nga dy të tilla që janë për momentin, do të bëhen katër shëtitore.

Ambienti i kuzhinës së QP Gjilan është i mirëmbajtur dhe shumica e pajisjeve janë funksionale, përveç shporeteve me gaz të cilët ishin jashtë funksionit dhe si rezultat përgatitja e ushqimit bëhet vetëm me shporet elektrik. Mostrat e ushqimit ruhen në rregull. Librezat sanitare po ashtu ishin të vërtetuara.

Monitoruesit e QKRMT-së vizituan edhe ambientet ku ruhen rezervat e ushqimit. Në QP Gjilan janë dy depo ku ruhen rezervat e ushqimit, depoja e përditshme dhe depoja emergjente. Në depon e përditshme rezervat ushqimore ishin në rregull, përfshirë edhe afatin e përdorimit. E njëjta praktikë nuk ishte edhe në depon emergjente, ku kishte produkte me afat të skaduar. *Gjatë observimit, aty u gjenden 16 qese kripë me peshë nga 500gr të cilat ishin me afat të skaduar në qershor 2021. Gjithashtu, edhe 9 qese me oriz me peshë nga 800gr ishin me afat të skaduar nga marsi 2021.*

Të burgosurit e intervistuar u shprehën kryesisht të kënaqur me ushqimin që ju shërbehet. Disa nga të burgosurit u ankuan në ushqimin që u ofrohet për darkë, ku zakonisht u jepet ushqim i konservuar. Kishte edhe të burgosur të cilët me rekomandim të mjekut ishin në regjim të ushqimit.

Sa i përket aktiviteteve në QP Gjilan, të dënuarit janë të angazhuar në punë, kryesisht në mirëmbajtje, në kuzhinë dhe renovimet që bëhen në këtë

institucion. Për të burgosurit është organizuar edhe një trajnim për menaxhimin e zemërimit.

Vizitat familjare realizohen dy herë në muaj. Për të burgosurit të cilët nuk kanë vizita të rregullta, ju mundësohet komunikimi përmes Skype. Të paraburgosurve u lejohen telefonatat një herë në javë. Përveç vizitave dhe telefonatave, u lejohen edhe shëtitje në ambient të hapur dy herë në ditë nga një orë.

Në QP Gjilan janë të vendosur edhe shtetas të huaj. Si shqetësim kryesor në trajtimin e tyre është mungesa e komunikimit, sidomos me shtetasit sirian, algjerian dhe të tjerë që flasin gjuhë arabe. Përveç vështirësive në komunikim nga stafi, kjo kategori ka probleme edhe me mbajtjen e kontakteve me familje. Për shkak të situatës në shtetet e tyre, ka probleme me komunikimin përmes Skype. Ata kërkojnë që t'u mundësohet të kontaktojnë familjet përmes whatsapp ose Viber. Gjithashtu një pjesë e tyre nuk kanë rroba mjaftueshëm, sidomos për sezonin e dimrit.

QKRMT ka rekomanduar që institucionet korrektuese, në bashkëpunim me gjykatat, të bëjnë përpjekje për t'u mundësuar komunikimin e rregullt me familjet e tyre, edhe përmes rrjeteve sociale. Kontakti i rregullt me familjen është në mesin e të drejtave bazike për personat e privuar nga liria, andaj edhe kërkojmë që të gjenden mundësitë për tejkalimin e këtij problemi.

Të paraburgosurit u ankuan në izolimin e tepërt dhe mungesën e aktiviteteve të lira. Kjo si rezultat i ndalesave dhe kufizimeve ligjore për këtë kategori, pasi që legjislacioni në fuqi nuk parasheh mundësi për ofrimin e aktiviteteve shtesë apo angazhimit në punë për të paraburgosurit. Edhe në QP Gjilan ka persona me paraburgime të gjata, që janë si rezultat i vonesave të gjykatave në vendosjen e rasteve, rigjykimet, etj. Gjatë 24 orëve, përveç shëtitjeve dy herë nga një orë, të paraburgosurit janë të mbyllur për pjesën tjetër të ditës. Përderisa janë me statusin e të paraburgosurit, ata kanë më pak të drejta, privilegje dhe aktivitete gjatë qëndrimit në institucionet

korrektuese. Kjo situatë po ndikon në shtimin e pakënaqësive të të paraburgosurve.

Megjithatë përveç kufizimeve në bazë të statusit të të paraburgosurve, në këtë qendër të paraburgimit nuk ka asnjë hapësirë të veçantë për realizimin e aktiviteteve, dhe rrjedhimisht nuk organizohet asnjë aktivitetet edhe për të dënuarit e vendosur në QP Gjilan. Për shkak të aktiviteteve të kufizuara për kalimin e kohës së lirë, të burgosurit kërkonin të paktën t'u sigurohet një tavolinë ping-pongu.

QKRMT ka vizituar njësinë shëndetësore në QP Gjilan. Sipas stafit mjekësor gjendja shëndetësore në QP të Gjilanit ishte stabile, edhe pse më shumë se gjysma e të burgosurve kanë nevojë për kujdes të caktuar mjekësor, përkatësisht nga rreth 200 të burgosur, 110 janë me terapi.

Të paraburgosurit me çrregullime mendor janë akomoduar në qeli të veçanta. Dy të burgosur ishin nën trajtim me metadon. Shërbimet stomatologjike ofrohen një herë në javë nga stomatologu që vjen nga qendrat tjera; pulmologu dhe psikiatri i jashtëm janë gjithashtu në detyrë një herë në javë. Laboratori është i pajisur për të kryer analizat bazë dhe furnizimi me medikamente duket i bollshëm dhe i menaxhuar mirë.

QKRMT ka shikuar dosjet mjekësore dhe protokollet. Sa i përket rasteve psikiatrike, në bazë të dosjeve kishte raste që nuk vizitohen rregullisht nga psikiatri. Në një rast i cili ishte pranuar më dt. 07.07.2021 me diagnozë psikiatrike dhe me terapi psikiatrike nga liria, është kontrolluar nga psikiatri më datë 07.09.2021, pra dy muaj pasi që është pranuar në institucion.

Në fund të vitit 2021, Ministria e Drejtësisë është pajtuar që Qendrën e Paraburgimit në Gjilan ta japë me qira, për transferimin e të burgosurve nga Danimarka në Kosovë. Pas përfundimit të procedurave si dhe nënshkrimit dhe ratifikimit të marrëveshjes, do të mbetet sfiduese transferimi dhe zhvendosja e stafit dhe të burgosurve nga kjo qendër.

9. QENDRA E PARABURGIMIT NË PRIZREN

Ekipi monitorues ka vizituar Qendrën e Paraburgimit (QP) në Prizren me 21 maj 2021. QP në Prizren akomodon të paraburgosur por edhe të dënuar dhe ka kapacitete prej 92 shtretër. Në ditën e vizitës monitoruese ishin të vendosur 81 të burgosur, nga të cilët 62 të paraburgosur dhe 19 të dënuar, ndërsa 2 gjendeshin në IPFK për ekzaminim psikiatrik. Në mesin e të dënuarve kishte me dënime të gjata, të dënuar deri në 24 vjet burgim.

Nga observimet e bëra në QP Prizren vërehej një atmosferë/klimë e mirë. Të burgosurit nuk paraqitën ndonjë ankesë evidente ndaj stafit. Meqë QP Prizren ka persona me paraburgime relativisht të gjata, ankesat kryesore të tyre kanë të bëjnë me efikasitetin e punës së gjykatave.

Kontrabandimi, kryesisht me telefona, mbetet prezent. Gjatë vitit të fundit QP Prizren është pajisur me një skaner dhe dy detektor, të cilët do të rrisin nivelin e sigurisë dhe mund të ndikojnë në parandalimin e kontrabandës.

QP në Prizren kishte gjithsej 82 anëtar të stafit. Mosha mesatare e stafit korrektues është rreth 52 vjeç.

Në QP Prizren gjendeshin dy të paraburgosur të klasifikuar me kategori të rrezikshmërisë. Sipas menaxhmentit, aktualisht ishin duke i menaxhuar pa ndonjë problem, megjithatë do të preferonin që të mos pranonin të burgosur të cilët janë të kategorizuar me rrezikshmëri.

QKRMT rekomandon ShKK-në të ketë parasysh statusin si qendër e paraburgimit, strukturën e objektit, përgatitjen e stafit si dhe lokacionin e institucionit, me rastin e vendosjes së personave të klasifikuar si të rrezikshëm.

Në ditën e monitorimit në QP Prizren kishte të burgosur me çrregullime mendore për të cilët kërkohej ekzaminim psikiatrik në IPFK, por në mungesa të hapësirave në IPFK janë vendos në këtë qendër. QP Prizren nuk ofron

kushte adekuate për trajtimin e kësaj kategorie, as nga aspekti i burimeve njerëzore profesionale, por as edhe nga kushtet materiale.

Një i paraburgosur i intervistuar kishte vendimin për mbajtje të paraburgimit në IPFK, mirëpo në mungesë të hapësirave ishte vendosur në QP Prizren. I burgosuri kishte probleme fizike dhe mendore dhe ishte thuajse i palëvizshëm. Menaxhimi i tij paraqet sfidë për stafit korrektues.

Nga vlerësimet e QKRMT-së, vendosja e të paraburgosurve me çrregullime mendore në qendra të paraburgimit, për të cilët gjykata ka shqiptuar vendimin për mbajtjen e paraburgimit në institucione të kujdesit shëndetësor, paraqet shkelje të dispozitave ligjore dhe të të drejtave të vet personave të paraburgosur. QKRMT e përsërit nevojën për caktimin e një institucioni të veçantë, i cili i plotëson kushtet materiale dhe njerëzore për trajtimin e kësaj kategorie.

Shqetësimet kryesore të të paraburgosurve ndërlidhen me punën e gjykatave por dhe me mungesën e aktiviteteve të lira në QP në Prizren.

Të dënuarit e QP Prizren paraqiten shqetësimet e tyre ndaj punës së PLK-së. Kanë ankesa ndaj shqyrtimit që ju bëhet kërkesave të tyre, përgjigjet e vonuara të PLK-së, etj. Këto shqetësime të të dënuarve u mbështetën edhe nga dy punëtorët social të kësaj qendre. Sipas punëtorëve social, edhe pse në raportet të cilat ata i përcjellin tek PLK-ja jepen vlerësime se të dënuar të caktuar e kanë arritur nivelin e risocializimit, në vendimet që i nxjerr PLK-ja shkruhet se këta persona, në bazë të raporteve të punëtorëve social, nuk e kanë arritur shkallën e mjaftueshme të risocializimit. Kjo praktikë e PLK-së, sipas punëtorëve social po sjell pakënaqësi tek të dënuarit, pasi që të dënuarit po konsiderojnë se janë punëtorët social ata të cilët kanë vlerësuar se nuk është arritur shkalla e risocializimit.

QP në Prizren mbetet në mesin e institucioneve korrektuese të cilat ende janë të vendosura në objekte të vjetra. Megjithatë, kishte pastërti të mjaftueshme, higjiena mbahet nga vet të burgosurit, ku disa nga të dënuarit janë të angazhuar në punë të pastrimit.

Për shkak të strukturës së objektit, dhomat janë të ngushta, ku vendosen kryesisht nga katër persona. Në të kaluarën QKRMT ka hasur raste kur për shkak të mbingarkesës, nëpër dhoma janë vendosur edhe nga pesë persona. Tashmë kjo praktikë nuk është e pranishme, megjithatë dhomat me hapësirat aktuale nuk i përmbushin kriteret ligjore për hapësirën e nevojshme që duhet të ketë secili i burgosur [Neni 36, LESP⁵].

Edhe pse sistemi i ventilimi është i vendosur nëpër dhoma, ai nuk është funksional. Sidomos në dhomat në QP Prizren brenda të cilave janë të vendosura tualetet, funksionimi i rregullt i ventilimit është i nevojshëm.

Në QP Prizren gjendja me dyshek dhe batanije ka qenë shumë e rënduar. Në fund të vitit 2020 kjo qendër është furnizuar me rreth 70 dyshek të rinj. Këta dyshek u janë shpërndarë të paraburgosurve. Të dënuarve u mundësohet të pajisen nga jashtë me dyshek. Megjithatë, të paraburgosurit u ankuan se nuk ka çarçafë për dyshekët e rinj.

QP Prizren ka qenë duke planifikuar të ndërtojë një dhomë të veçantë, e cila do të jetë e pajisur me kamera dhe do të shfrytëzohet për rastet e mbikëqyrjes së vazhdueshme.

Përkundër objektit të vjetër, hapësira e kuzhinës ishte e mirëmbajtur në përgjithësi. Gjatë monitorimit janë evidentuar disa hapësira të dëmtuara, përkatësisht një pjesë e tavanit ishte e dëmtuar, po ashtu pllakat në sallën e ngrënies afër kuzhinës ishin të dëmtuara, ku disa pllaka mungonin ndërsa disa ishin shumë të dëmtuara të cilat paraqesin rrezik duke pasur parasysh që në të atë ambient ushqehen oficerët dhe të dënuarit.

⁵ Lokalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë [8] metra kub hapësirë dhe kur është e mundshme nëntë [9] metra katrorë për të dënuarit në qeli të përbashkëta dhe katër [4] metra katrorë për të dënuarit në qeli të vetme, dhe sasi të mjaftueshme të dritës natyrore dhe artificiale për punë dhe lexim, ngrohje dhe ajrosje.

Lokalet nuk duhet të kenë lagështi dhe duhet të kenë pajisje sanitare adekuate dhe mjete të tjera të nevojshme për higjienë personale.

Aparatura e kuzhinës punonte në gjendje të rregullt. Makina për larjen e enëve nuk kishte detergjent përkatës. Në pjesën hyrëse të kuzhinës nga katër lavabot vetëm njëri ishte funksional.

Në periudha të ndryshme, kanë qenë të ndaluara vizitat e familjarëve për shkak të pandemisë COVID-19. Si zëvendësim të vizitave, të burgosurve u janë lejuar telefonata më të shpeshta, dhe u është mundësuar komunikimi përmes Skype. Skype ishte në dispozicion për të burgosurit të cilët nuk kanë vizita. Të burgosurit kërkonin të përmirësohen kushtet për përdorim të Skype, pasi që ishin vetëm dy kompjuter të vjetër.

Të dënuarit kanë mundësi të shkojnë pranë familjeve të tyre gjatë fundjavave. Mbetet kërkesë e vazhdueshme shtimi i numrit të ditëve të fundjavave brenda vitit.

Sa i përket aktiviteteve, në dispozicion për të dënuarit është një numër i kufizuar i tyre. 15 nga të dënuarit ishin të angazhuar në punë, kryesisht në kuzhinë dhe pastrim.

Shëtitorja është shumë e vogël, dhe gjithashtu kanë një tavolinë pingpongu si dhe koshin e basketbollit. Të paraburgosurit u ankuan në izolimin e tepërt dhe mungesën e aktiviteteve të lira.

Ekipi monitorues vizitoi ambientet shëndetësore në QP Prizren. Kushtet fizike në QP në Prizren nuk janë të përshtatshme për funksionimin adekuat të njësisë shëndetësore, pasi që mungojnë ambientet e veçanta për mjekun dhe psikiatrin, përkatësisht në një sallë të vetme ofrohen të gjitha shërbimet [infirmierie, shëndetësore dhe psikiatrike]. Gjithashtu, barnatorja nuk ka hapësirë të përshtatshme dhe adekuate. Njësia shëndetësore në QP Prizren ishin të furnizuar mjaftueshëm me pajisje dhe mjete higjienike për parandalimin e Covid-19.

Për të burgosurit në QP Prizren ofrohen shërbime shëndetësore të përgjithshme të rregullta. Po ashtu, janë të angazhuar [part-time] psikiatri,

radiologu dhe stomatologu. Karriga stomatologjike dhe mjetet përcjellëse ishin plotësisht funksionale, megjithëse kushtet përkatësisht ambienti ku ishte vendosur karriga stomatologjike ishte jo e përshtatshme pasi nga dhoma e vizitave është adaptuar në dhomë stomatologjike, por që edhe në ato kushte janë duke u kryer vizitat stomatologjike sipas kërkesave të të burgosurve.

Hapësira në të cilën është vendosur barnatorja përveç që është në një ambient pa ndriçim dhe kushte jo të mira, përdoret edhe për qëllime të tjera, përkatësisht intervistat e të burgosurve nga ana e hetuesve realizohen në atë ambient. Barnat në barnatore të cilat janë monitoruar ishin me afat, ndërsa në dhomën stomatologjike, *ishin 10 shiringa - 2 ml me afat të skaduar*. Barnave të tjera që u kishte skaduar afati ishin të veçuara në një pako sipas listës së afatit të skadimit. Shqetësuese mbetet menaxhimi i barnave me afat të skaduar të cilat për disa vite mbahen në një depo të veçante.

Në bazë të dosjeve të të burgosurve, vërehet që ka vonesa në dërgimin e vizitave mjekësore jashtë institucionit. Në disa prej dosjeve të shikuara janë evidentuar vonesa në vizita mjekësore përkundër caktimit të prioritetëve nga stafi shëndetësor. P.sh. në disa raste prioriteti i trajtimit nga mjeku i QP Prizren ishte përcaktuar me "B" [trajtimi brenda 24 orëve], ndërsa në bazë të raporteve mjekësore vërehej që vizita mjekësore është realizuar pas këtij afati. Sipas stafit mjekësor, këto vonesa po shkaktohen nga ana e gjykatave pasi që në rastet me paraburgim duhet leje nga gjykata për vizitë mjekësore jashtë institucionit.

10. QENDRA E PARABURGIMIT NË PEJË

Qendra e Paraburgimit (QP) në Pejë është monitoruar me 27 tetor 2021. QP në Pejë akomodon të paraburgosur por edhe të dënuar dhe ka kapacitete prej 80 shtretër. Në ditën e monitorimit prezent ishin gjithsej 70 të burgosur, nga të cilët 65 të paraburgosur dhe pesë të dënuar. Në IPFK gjendej një i burgosur. Gjithashtu, gjendeshin edhe tetë persona të huaj, dhe një i paraburgosur ishte i klasifikuar me kategorinë e rrezikshmërisë së lartë.

Sipas vlerësimit të QKRMT-së, në QP Pejë është një atmosferë/klimë e mirë. Të burgosurit nuk patën ndonjë ankesë ndaj stafit. Ankesat kryesore të të burgosurve kanë të bëjnë me efikasitetin e punës së gjykatave.

Shqetësim në QP Pejë mbetet infrastruktura e dobët për shkak të objektit të vjetër. Sipas menaxhmentit, prioritet është përmirësimi i nyjave sanitare dhe ventilimit të dhomave dhe korridoreve. Sa i përket furnizimit me ushqim dhe pako higjienike, zyrtarët udhëheqës të qendrës deklaruan se ishte i mjaftueshëm.

Aktualisht QP Pejë i ka 107 anëtar të stafit. Si në shumicën e qendrave edhe në QP Pejë mosha mesatare e stafit korrektues është rreth 53 vjeç. Rregullisht ka anëtar të stafit të cilët janë duke u pensionuar dhe nevojitet rekrutim i stafit korrektues.

Nga monitorimi i realizuar, QKRMT nuk ka pranuar ankesa apo pohime nga të burgosurit për keqtrajtim në këtë qendër. Të gjithë të intervistuarit kanë deklaruar se kanë raporte të mira me stafin korrektues.

Në QP Pejë ishin të vendosur një i paraburgosur i klasifikuar me kategori të rrezikshmërisë së lartë-për terrorizëm dhe 8 shtetas të huaj.

Sipas menaxhmentit të QP Pejë, nuk kishte ndonjë problem gjatë menaxhimit dhe nuk ka pasur incidente të rënda apo përdorim të forcës. Është raportuar se ka incidente në mes të paraburgosurve, ku kjo është vërtetuar edhe në bazë të dosjeve mjekësore, ku të gjitha lëndimet e

evidentuara në protokollin e lëndimeve, ishin raste nga incidentet mes të paraburgosurve.

Shqetësimet kryesore të paraburgosurve ndërlidhen me punën e gjykatave. Të paraburgosurit e QP Pejë gjithashtu paraqitën shqetësimet e tyre ndaj punës së Prokurorisë lidhur me vonesat e shumta në shqyrtim të rasteve / marrjen në pyetje. Ekipi monitorues takoi të paraburgosur të cilët gjendeshin në paraburgim për më tepër se 6 muaj pa u marrë në pyetje nga prokuroria.

QP Pejë mbetet në mesin e institucioneve korrektuese të cilat ende janë të vendosura në objekte të vjetra. Përkundër këtij fakti, vërehet se ka pastërti të mjaftueshme.

Për shkak të strukturës së objektit, dhomat janë të ngushta. Nëpër dhoma vendosen kryesisht nga tre-katër persona. Dhomat me hapësirat aktuale nuk i përmbushin kriteret ligjore për hapësirën e nevojshme që duhet të ketë secili i burgosur [Neni 36, LESP⁶].

Mosfunksionimi i ventilimit nëpër dhoma dhe korridore është shqetësim i ngritur edhe nga vet menaxhmenti, sidomos duke pasur parasysh që në dhoma janë të vendosura banjat. Në muret e disa dhomave janë vërejtur gjurmë të lagështisë të formuara nga rrjedhjet e ujit, ndërsa në të gjitha banjat e dhomave të vizituara është vërejtur lagështi dhe formim i mykut. Gjithashtu, gjatë vizitës në depon e ushqimit në njërën qoshe është vërejtur formim i mykut nga lagështia. Në këtë qendër, dhomat e banimit nuk kanë qasje të drejtpërdrejtë në dritë natyrore. Sa i përket kushteve materiale, një ndryshim pozitiv që ka ndodhur në ShKK është furnizimi vitin e kaluar me dyshek të rinj me material kundër-zjarrit, jastëk dhe bataniye të reja.

⁶ Lokalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë [8] metra kub hapësirë dhe kur është e mundshme nëntë [9] metra katrorë për të dënuarit në qeli të përbashkëta dhe katër [4] metra katrorë për të dënuarit në qeli të vetme, dhe sasi të mjaftueshme të dritës natyrore dhe artificiale për punë dhe lexim, ngrohje dhe ajrosje.

Lokalet nuk duhet të kenë lagështi dhe duhet të kenë pajisje sanitare adekuate dhe mjete të tjera të nevojshme për higjienë personale.

Sa i përket aktiviteteve, në dispozicion për të dënuarit është një numër i kufizuar i tyre. 5 nga të dënuarit janë të angazhuar në punë, kryesisht në kuzhinë dhe pastrim. Gjithashtu, e kanë në dispozicion shëtitoren, e cila është shumë e vogël, dhe një tavolinë pingpongu. Të paraburgosurit u ankuan në izolimin e tepërt dhe mungesën e aktiviteteve të lira. Kjo si rezultat i ndalesave dhe kufizimeve ligjore për këtë kategori, pasi që legjislacioni në fuqi nuk parasheh mundësi për ofrimin e aktiviteteve shtesë apo angazhimit në punë për të paraburgosurit.

Ndër ankesat më të shpeshta është numri i vogël i kanaleve të TV. QKRMT rekomandon QP në Pejë dhe ShKK që të mundësojnë shtimin e numrit të kanaleve televizive, pasi që aktualisht janë të qasshëm vetëm 3 kanale televizive.


Ekipi monitorues ka vizituar ambientet shëndetësore në QP Pejë. Kushtet fizike në QP në Pejë nuk janë të përshtatshme për funksionimin adekuat të njësisë shëndetësore, pasi që mungojnë ambientet e veçanta për mjekun dhe psikiatrin, përkatësisht në një sallë të vetme ofrohen të gjitha shërbimet [infirmierie, shëndetësore dhe psikiatrike]. Së fundmi, kësaj njësie i është ofruar edhe një hapësirë shtesë për vendosje të karriges stomatologjike si dhe janë furnizuar edhe me një laborator për analiza. Të dyja këto shërbime pritet që të funksionalizohen së shpejti.

Njësia shëndetësore në QP Pejë ishte e furnizuar mjaftueshëm me pajisje dhe mjete higjienike për parandalimin e Covid-19. Vaksinimi është kryer me rregull dhe brenda institucionit, dhe dozat janë siguruar në bashkëpunim me qendrën e vaksinimit në Pejë, sipas nevojës.


Për të burgosurit në QP Pejë ofrohen shërbime shëndetësore të përgjithshme të rregullta, ndërsa psikiatri vjen katër herë në muaj. Në këtë qendër nuk ka psikolog të rregullt, por ka vetëm psikolog konsulentë, i cili vjen sipas nevojës.

Në bazë të evidencave nëpër protokolle vërehet se në këtë qendër numri i rasteve të lëndimeve kishte shënuar rënie, përkatësisht gjatë vitit 2020 janë evidentuar 26 raste të lëndimeve ndërsa deri më 27 tetor 2021 janë

evidentuar 7 raste të lëndimeve (që të gjitha nga incidentet ndërmjet të burgosurve).



REKOMANDIMET



QKRMT gjatë vitit 2021 ka realizuar 16 vizita monitoruese në institucionet korrektuese të Kosovës. Gjatë këtyre vizitave, janë evidentuar zhvillime pozitive në sistemin korrektuese, si në aspektin e kushteve materiale, ashtu edhe në trajtimin dhe shërbimet shëndetësore që ju ofrohen të burgosurve.

Megjithëkëtë, me qëllim të avancimit të sistemit korrektues në Kosovës dhe sigurimin e trajtimit adekuat për personat e privuar nga liria, duke u bazuar në gjetjet e evidentuara nga monitorimi, QKRMT i paraqet organeve kompetente rekomandimet e mëposhtme:

- Të ndërmerren veprime konkrete për përmirësimin e trajtimit të të burgosurve, duke përfshirë:
 - Zhvillimin e mëtejshëm të vlerësimit fillestar dhe të planit individual;
 - Forcimin e shërbimeve sociale, rritjen e numrit të punëtoreve social;
 - Zhvillimin e programe për trajtimin e të burgosurve me varësi nga substancat narkotike;
- Të forcohet mekanizmi i brendshëm i ankesave, në aspekt të rritjes së konfidencialitetit; të burgosurve t'u ofrohen përgjigje brenda afati të përcaktuar në kërkesa/ankesat e tyre;
- Të ofrohet trajtim i përshtatshëm për të burgosurit me probleme mendore;
- Të shtohen kapacitetet akomoduese në Institutin e Psikiatriisë Forenzike;
- Të sigurohet qëndrueshmëri në menaxhimin e ShKK-së dhe institucioneve korrektuese;
- ShKK duhet të ndërmarrë veprime për respektimin e garancive kundër keqtrajtimit:
 - Menaxhmenti i institucioneve korrektuese t'i shtojë përpjekjet për t'i vetëdijesuar stafin korrektues se të gjitha format e keqtrajtimit janë të ndaluara dhe të dënueshme. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet edhe abuzimit verbal ndaj të burgosurve;

- Të zbatohen në përpikëri procedurat me rastin e pohimeve për keqtrajtim;
- Në rast të përdorimit të forcës, të burgosurit t'i mundësohet menjëherë qasja tek mjeku, kurse për stafin korrektues të bëhet vlerësim i detajuar mbi nevojën e përdorimit të forcës;
- Inspektorati i Ministrisë së drejtësisë të zhvillojë hetime më të detajuara në rastet e pohimeve për keqtrajtim;
- T'i kushtohet vëmendje më e madhe menaxhimit të incidenteve mes të burgosurve, vetëlëndimeve dhe tentim vetëvrasjeve;
- Vëzhgimi me kamera në dhomat e vetmisë të rregullohet me dispozita të veçanta përmes akteve nënligjore, në mënyrë që të shmangen mundësitë e keqpërdorimit dhe shkeljes së privatësisë dhe dinjitetit të të burgosurve.
- Shërbimi Shëndetësor duhet të vazhdojë përmirësimin e kualitetit të shërbimeve:
 - Të shtohet numri i stafit, sidomos i psikologëve dhe psikiatërve;
 - Në institucionet e mëdha, siç është BSL, të ketë mjek 24h;
 - Të burgosurit me varësi nga narkotikët, të fillojnë pa vonesa programin e metadonit;
- ShShB duhet t'i kushtojë rëndësi menaxhimit të barnave pa afat. Assesi nuk duhet të vendosen në të njëjtin ambient me barnat me afat të rregullt;
- ShShB duhet t'i mbajë me kujdes protokollet; vëmendje e veçantë duhet kushtuar evidentimit të rasteve të pohuara për keqtrajtim fizik;
- Ministria e Drejtësisë dhe ShKK, brenda kompetencave të tyre, të adresojnë çështjen e funksionimit të mirëfilltë të Panelit për Lirim me Kusht;
- Ministria e Drejtësisë dhe ShKK duhet të ndërmarrin veprime konkrete për avancimin e Njesisë Ekonomike. Është shumë e nevojshme shtimi i mundësive për të punuar të burgosurit, si në aspektin e rehabilitimit të të burgosurve, ashtu edhe në përfitimet që do t'i kenë institucionet korrektuese nga rezultatet e punës;

- Të shtohen trajnimet profesionale për të dënuarit si dhe aktivitetet ku ata mund të angazhohen gjatë kohës së lirë;
- Të ndërmerren veprime lidhur me parandalimin e korrupsionit;
- Të gjithë të burgosurve duhet t'u sigurohet mjaftueshëm ujë i ngrohtë për mirëmbajtje të higjienës personale;
- ShKK të sigurojë furnizim të mjaftueshëm dhe të rregullt me produkte higjienike;
- Të shtohet numri i stafit civil dhe zyrtarëve korrektuese si dhe të përmirësohen kushtet e punës për ta.

Publikimet:

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës [QKRMT]
Mars 2022

Kontakti:

QKRMT

Rr. Hamëz Jashari 16b/2

10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 [0]38 243 707

E-Mail: info@krct.org

Web-faqja: www.krct.org

Katalogimi në botim – [CIP]

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

316.347.2[496.51]"2021"[046]

Haliti, Fatmire

Të drejtat e njeriut në institucionet korrektuese në Kosovë : raport monitorimi 2021
/ Fatmire Haliti. – Prishtinë : Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të
Torturës, 2022. – 104 f. ; 24 cm.

Të drejtat e njeriut -- Institucionet sociale -- 2021 -- Raporte – Kosovë

ISBN 978-9951-774-11-6

Aleph [000101767]

ISBN 978-9951-774-11-6



9 789951 774116